

**Emri**  
Të vonuar  
kundrejt kushtit  
"erga omnes"

Fq.3



**GAZETA FT**  
E ardhmja e  
Ballkanit varet  
nga marrëveshja  
Greqi-Maqedoni

Fq.4



Asgjë nuk  
më shtyn të  
largohem  
nga Milani

**Suso**

Fq.21



# Koha

www.koha.mk



Një tjetër  
Melanie

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3360 · e mërkurë 9 maj, 2018

12°C | 26°C

15 DEN

## FORUM

**Rikonstruimi  
i Qeverisë,  
çka dhe si?**



Ka kohë që tema më e nxehtë me të cilën hapen edicionet e lajmeve të mediave kryesore, por edhe të atyre më pak të rëndësishme, është rikonstruimi i qeverisë. Dhe, gati se gjithmonë, brenda lajmeve që ndërlihen me temën në fjalë përshkohet dy çështje si arsye për një hap të tillë të kryeministrit: zgjerimi i shumicës parlamentare dhe përmirësimi i kualitetit të kuadrove që udhëheqin me dikasteret qeveritare. Përdërisa vet kryeministri, gati se gjatë gjithë paraqitjeve të tij publike, gjatë arsyetimit të nevojës për riformatim të kabinetit qeveritar preferon të vë...

Fq.10

## RAJON

**Sa ka  
punë për  
70 zëvendës-  
ministra?**

Fq.12

## EDITORIAL

**Haraçi i  
dembelisë së  
deputetëve**

Fq.2



## PARALELJA E TENISIT VETËM NË QYTETET MAQEDONASE

# "AKADEMIA E SPORTIT" LARG SHQIPTARËVE



Thuajse të gjitha paralelet e SHMSH "Akademia Sportive" të formuara deri tani janë në gjuhën maqedonase, ndërsa pritet që ai raport të thellohet dhe më tej në disfavor të shqiptarëve për vitin shkollor 2018/2019. Përrjashtoj kryeqytetin, të gjitha seleksionimet tjera për fazën paraprake janë realizuar në qytete me shumicë maqedonase

Fq.6

## Kazinonë në Reçicë s'ka kush e ndalë

Tetovë, 8 maj - Kazinonë në Reçicë të Vogël vazhdon të mbushet me aparate e me arka. Në videon e cila është bërë virale në rrjetet sociale shihen se si disa persona fusin aparate në objektin për të cilin thuhet se do hapet kazino. Organizatorët e protestave kanë theksuar se kjo është e papranueshme ngase edhe përkundër revoltës së qytetarëve, megjithatë kazinoja vazhdon të bëhet gati për hapje. Jushi

Emurllai një nga organizatorët e kësaj proteste, nënvizon se edhe pse kanë patur premtime që të mos hapet kazinoja deri në arritjen e një marrëveshje që të mos punohet, kjo nuk është respektuar. "Pas protestës së ditës së premtë neve nuk na ka kontaktuar askush. Nuk është ndërmarrë asnjë masë që kazinoja të mos hapet dhe të ndërpriten punët përgatitore. Vazhdimin e punëve e marrim..."

Fq.7



## EDITORIAL

HARAÇI I  
DEMBELISË SË  
DEPUTETËVE

Emin AZEMI

Mizat e shkreta paguajnë më së shumti haraçin e dembelisë së deputetëve tanë, sepse vetëm ato mbajnë mbi supe fuqinë e ndikimit që deputetët ushtrojnë, sa herë që atyre iu mungojnë idetë për të iniciuar ndonjë ide me interes publik për zonën e tyre elektorale

Sa po merren deputetët shqiptarë me detektimin e problemeve të karakterit ekonomik e social në mjediset prej nga vijnë ata? Sa ata po ju ndihmojnë banorëve të zonave rurale të vijnë më lehtë të burimet e financimit për të mëkëmbur bujqësinë, blegtorinë...? Cilat projekte zhvillimore i kanë inicuar ata, e që janë refuzuar nga Qeveria dhe institucionet shtetërore?

Sa deputetë shqiptarë kanë mbajtur tubime joformale me mërgimtarët tanë për t'u informuar më për së afërmi me idetë dhe planet e tyre që do t'i realizonin në vendlindje?

Mund të radhisim edhe shumë pyetje të tjera, por këto mjaftojnë për të shtruar një problem jetik që lidhet me rolin e deputetit dhe lidhjen e tij me hallet dhe problemet e bazës elektorale. Jo se deputetët tanë nuk i dinë detyrat dhe obligimet për të cilat edhe e kanë marrë mandatin nga populli, por nga inercia e punëve rutinoze që zakonisht ndodhin në Parlament, vëmendja e tyre rastis edhe të defokusohet nga problemet e mësipërme dhe për rrjedhojë mund të fitohet përshtypja se ata asgjë nuk punojnë. Ose, të krijohen hamendësime në publik se deputetët tanë më tepër angazhohen për probleme gjeostrategjike të globit, e më pak me problemet e lagjes apo fshatit prej nga vijnë ata.

Që të mos ketë hamendësime dhe mjegullime të panevojshme, megjithatë do të duhej të thuhet se në përbërjen aktuale parlamentare ka deputetë shqiptarë që me kulturë të lartë përgjegjësie dhe me sens të zhvilluar profesional po i kryejnë obligimet e tyre, duke qenë madje jo rrallë edhe në ballë të ideve e nismave me rëndësi fundamentale për të ardhmen e këtij shteti.

Por, në anën tjetër, ka edhe mjaft deputetë gjumash (këta dominojnë), të cilët në Kuvend shkojnë vetëm sa për të marrë rrogën dhe mëditjet, kurse materialet që i marrin nga shërbimet, shpesh i përdorin (pa i lexuar), ose për të ndezë stufën në shtëpi (në kohë dimri), ose për të fshirë xhamat e pluhurosur të shtëpisë (në kohë vere).

Sikur të mos ekzistonte kategoria e parë e deputetëve, që përmendëm më lartë, do të fitohej përshtypja sikur Kuvendi është një berberhane që pret e përcjell njerëz për të qethur mërzitë e tyre të grumbulluara nga dembelia e mospuna. Zaten plotë deputetë nganjëherë i shohim të paqethur e parruar, për faktin se ata i kaplon aq shumë mërzia sa nuk dinë prej nga t'ia nisin ta vrasin kohën. Sigurisht këtu mund ta ketë burimin edhe zhurma që dëgjohet në zyrat e tyre, ndonëse tash së fundmi e kuptuam se ajo nuk kishte qenë zhurma e tastaturës së laptopit, duke shkruar ndonjë projekt zhvillimor, por e përplasjes së shuplakave teksa zënë pisk ndonjë mizë. Mizat e shkreta paguajnë më së shumti haraçin e dembelisë së deputetëve tanë, sepse vetëm ato mbajnë mbi supe fuqinë e ndikimit që deputetët ushtrojnë, sa herë që atyre iu mungojnë idetë për të iniciuar ndonjë ide me interes publik për zonën e tyre elektorale.

## KUR FLET MIRJANA

"E paska thënë edhe Mirjana Marković, gruaja e vrasësit serb Slobodan Milošević, që shtetin e Kosovës e formuan joshqiptarët nga jashtë që i përdorën shqiptarët. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk ka shtet që është çliruar apo formuar pa sakrificat vetanake dhe ndihmë nga të tjerët. Shteti i Kosovës është përpjekje titanike çlirimtare njëshekullore e shqiptarëve që e detyroi politikisht dhe obligoi moralisht krejt botën të pranojnë dhe ndihmojnë vullnetin e shqiptarëve për shtet dhe hapje të rrugës për vetëvendosje për bashkim kombëtar kur të vie koha. Këtë tezë të gabuar dhe antishqiptare gjoja se të tjerët e kanë formuar Kosovën dhe bile edhe Shqipërinë londineze si shtete e shtyejnë edhe disa shqiptarë. Deklarata e Markovićit e zbulon me kënd janë këta shqiptarë në shtrat - me gruan më të zezë të 100 vjetëve të fundit në Ballkan - Mirjana Milošević", shkruan në profilin e tij në FB, aktivisti nga Amerika, Uk Lushi.



## NJERËZIT QË FLASIN NË EMËR TË KOMBIT

"Shqiptarët realisht më tepër ikin në Gjermani. Unë kam një informacion direkt nga ambasada e Gjermanisë, se në ditë u ndahen viza 75 personave nga Maqedonia. Kjo i bie që afro 1500 njerëz në muaj ikin nga Maqedonia. Në qoftë se sot lajmëroheni për termin në ambasadë për vizë pune, do merrni diku në nëntor terminin. Ka një fluks të madh të ikjeve që është shqetësues. Njohës të mi thonë që edhe ambasada e Zvicrës ndanë diku nga 500 deri 700 viza në muaj. Nëse i kombinoni këto 1500 me ato 500 do bëhen 2000 veta dhe kjo është shumë, dhe bëhet fjalë kryesisht për të rinj. Autoritetet që duhet të japin përgjigje janë ato shqiptare. Është kollaj të vejmë gishtin tek pala shqiptare, por ne kemi përfaqësues. Kemi njerëz të cilët flasin në emër të kombit, shqiptarisë, i bien çiftelisë e sharkisë gjithë ditën dhe flasin për flamurin dhe kombin, por kur vie puna të jetojnë me problemet ditore të shqiptarëve ato e hudhin fajin dhe thonë se nuk kanë fuqi më tepër. Unë jam njeri i cili është kthyer duke besuar se konceptit se një ditë ky shtet do të rregullohet. Nga 2015 e këtej, e posaqërisht nga ky depresion i fundit dhe me këtë lloj politike kadrovike që bën LSDM-ja por edhe BDI-ja, unë nuk kam të drejtë morale ti them dikujt rri në Maqedoni se do të bëhet më mirë", shkruan në profilin e tij në FB, prof. Visar Ademi.



## TREGTIA ME ZOTIN

"Kujt prej nesh i ka shkuar mendja dhe ka filluar të përgatitet për ta pritur këtë muaj?! Të gjithë ne e dimë, se ai person që ka një dasëm në shtëpinë e tij, të paktën dy-tre javë përpara fillon të bëhet gati, sepse nuk mund t'i presë miqtë e tij pa u përgatitur. Ky është ligj në jetë. Kurse Ramazani nuk është një ditë por është një muaj. Nuk ta sjell ndonjë person, por vjen direkt nga Allahu (xh.sh), Zoti i botërave. Unë pyes: 'Kush është ai që di ta presë siç duhet këtë muaj ashtu si i ka hije. Ramazani është sezon tregtie. Nuk është tregti për të fituar para, por është tregti me Allahun (xh.sh), tregti nga e cila mund të fitojmë xhennetin. E çfarë mund të kërkosh më shumë se kaq?!", shkruan teologu Hasan Baftijari.



## MEDIACitate

KOSOVA NUK  
ËSHTË MË  
KRYESORJA  
PËR SERBËT

Sipas një hulumtimi, të kryer nga agjencia Faktor Plus, zgjidhja e çështjes së Kosovës nuk përbën prioritetin kryesor për serbët. Ata kanë vënë në plan të parë zhvillimin ekonomik të vendit, transmeton Koha.net shkrimin e publikuar sot në të përditshmen "Politika". Numri më i madh i qytetarëve të Serbisë, 92 për qind e tyre konsideron ndër prioritetet të Serbisë më kryesorin zhvillimin ekonomik të shtetit. Prioritet me rëndësi ata kanë vënë edhe eliminimin e krimit dhe të korrupsionit - 89 për qind e qytetarëve të anketuar, ndërsa për paqe dhe stabilitet politik janë deklaruar 86 për qind e respondentëve të këtij hulumtimi të agjencisë Faktor Plus. Pas këtyre vijnë drejtësia sociale dhe solidariteti - 78 për qind, ndërsa zgjidhjen e çështjes së Kosovës e kanë vënë ndër prioritetet 46 për qind e të anketuarve. Për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Europian janë deklaruar 36 për qind e tyre, kurse për zhvillim të demokracisë - 14 për qind. Sipas këtyre përqindjeve, çështja e Kosovës nuk është nga ato më kryesoret për qytetarët e Serbisë, por drejtori i agjencisë Faktor Plus citohet të ketë thënë se interesimi për këtë çështje ka shënuar rritje. Sipas tij, para një viti vetëm 16 për qind e qytetarëve kishin deklaruar se çështja e Kosovës duhet të zgjidhet një orë e më parë. Ky hulumtim është kryer nga data 2 deri më 6 maj, ndërsa në të kanë marrë pjesë 1.040 respondentë.

(Politika, 8 maj)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## ÇFARË ISHTE KONGRESI I ELBASANIT?

Kongresi i Elbasanit (2-8 shtator 1909) ishte mbledhje me karakter mbarëshqiptar, që mori vendime të rëndësishme për përhapjen e shkollave shqipe dhe për probleme të tjera. Morën pjesë 35 përfaqësues të klubeve dhe shoqërive shqiptare. Kongresi vendosi që të themelohej në Elbasan një shkollë e mesme pedagogjike shqipe me gjashtë klasa, që do të përgatiste mësues për shkollat fillore shqipe dhe do të mbahej me kontributin e të gjitha

klubeve dhe shoqërive shqiptare. U vendos gjithashtu të ngrihej në Korçë shoqëria qendrore shkollore "Përparimi", e cila do të kujdesej për mbajtjen dhe administrimin e shkollës normale, do të punonte për hapjen e shkollave të tjera shqipe, për botimin e librave dhe teksteve shqipe. Vendimet e Kongresit të Elbasanit i dhanë një hov të mëtejshëm lëvizjes kombëtare dhe luftës për hapjen e shkollës e të shkrimit shqip.

Në Maqedoni, duket se po vonohen punët për të ndërtuar konsensusin e brendshëm politik me të gjitha faktorët politik, ndër ta edhe opozita maqedonase, thonë analistë politik dhe ekspertë të çështjeve evropiane

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 8 maj - Më 17 maj në Sofje të Bullgarisë në margjina të Samitit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, është planifikuar të takohen kryeministri Zoran Zaev me kryeministrin grek Aleksis Cipras. Siç njoftojnë mediat greke, në takim midis dy kryeministrave pritet të kërkohej modaliteti për zgjidhjen përfundimtare të kontestit disa vjeçar të emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë. Sipas burimeve diplomatike, është arritur përparim i dukshëm në shumë tema e që janë pjesë e bisedimeve, edhe përkundër asaj se ka mbetur dallimi kryesor rreth përdorimit të emrit "erga omnes", ndërkaq Zaevi dhe Cipras kanë "komunikim të vazhdueshëm telefonik edhe pse bisedimet mes tyre dhe kontaktet nuk bëhen publike". Por nga ana tjetër, në vend ende duket se po vonohen punët për të ndërtuar konsensusin e brendshëm politik me të gjitha faktorët politik, ndër ta edhe opozita maqedonase, kjo sipas asaj që thonë analistë politik dhe ekspertë të çështjeve evropiane.

#### OPINIONI I PAPËRGATITUR

"Për momentin, është e qartë se qeveria nuk e ka përgatitur opinionin për pranimin e një emri të ri edhe për përdorim të brendshëm, gjë që padyshim e bën zgjidhjen e çështjes se emrit edhe më të komplikuar", mendon analisti politik Ibrahim Mehmeti. Mbetet të shihet, shton ai, nëse kjo çështje do të tentohet të zgjidhet ndoshta me referendum ose në ndonjë formë tjetër, por në çdo rast - thekson Mehmeti, është e domosdoshme që opinioni i brendshëm të përgatitet për një zgjidhje të këfillë.

"Nga ana tjetër, duket qartë se Greqia nuk është e gatshme për zgjidhje të problemit nëse kjo nuk është 'erga omnes', gjë që e vendos qeverinë dhe kryeministrin para një testi shumë të madh", thotë Mehmeti. Ai vlerëson se opozita duhet kyçur sa më shpejtë të jetë e mundur në procesin për emrin, ngaqë sipas Mehmetit, ajo mund të krijojë probleme që do ta vështirësonin arritjen e rezultatit final. "S'ka dyshim se për zgjidhje përfundimtare të këtij problemi do të jetë e domosdoshme të kyçet edhe opozita, sepse në qoftë se ajo e kundërshton dhe e politizon procesin e marrëveshjes, atëherë është vështirë të pritet rezultat i kënaqshëm. E nga ana tjetër, mund të ndodhë që opozita ta shfrytëzojë këtë për pika politike, gjë

LARG APO AFËR ZGJIDHJES FINALE PËR ÇËSHTJEN E EMRIT ME GREQINË

# TË VONUAR KUNDREJT KUSHTIT "ERGA OMNES"



#### NANO RUZHIN

**Emri është gjetur, a bëhet fjalë për Maqedoni Veriore ose të Epërme, tashmë ekziston konsensus për këtë çështje. Problemi tani qëndron tek garancat që të dyja palët, e në veçanti pala greke i kërkon se vallë, Maqedonia do ta respektojë emrin e ri të vendit. Për këtë arsye, të dyja palët kërkojnë para qytetarëve garanci për ndryshime Kushtetuese.**

që do të ishte shumë e dëmshme edhe për shtetin, por edhe për opozitën, mirëpo megjithatë kjo nuk mund të përjashtohet", thotë Mehmeti. Për ekspertin e çështjeve evropiane Muhamer Pajaziti, kryeministri Zoran Zaev me përkrahje të opozitë dhe të partive shqiptare do të ishte më komod në bisedat direkte me palën greke për çështjen e emrit.

"Po të kish ndërtuar deri më tani kryeministri Zoran Zaev një formulë të përbashkët për bisedime direkte me të gjitha faktorët në vend, pra me opozitën maqedonase dhe me partitë shqiptare, do të ishte më komod në biseda direkte me kryeministrin Cipras për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar me emrin. Si duket, Zaev duke e ditur se e presin ndryshimet kushtetuese dhe referendumi që vetë e ka paralajmëruar, po vonohet me qëllim që palës greke ti bëhet e ditur se edhe ajo duhet të lëshojë pe në përdorimin e emrit 'erga omnes', meqë ai vet nuk mund të marrë hapa radikal për një zgjidhje afatgjatë", thekson Pajaziti. Sipas tij, nëse pala maqedonase nuk lëviz drejt rishikimit të histori-

#### DIMITRIS XANAKOPOLOS

**Është e nevojshme marrëveshje ku qartazi do ti përshkruante hapat e zgjidhjes. Ndryshim të emrit në marrëdhëniet ndërkombëtare, pastaj ndryshim të Kushtetutës të IRJM-së, dhe pastaj vjen mbështetja e Greqisë për integrim të fqinjët në gjitha organizatat ndërkombëtare. Kjo është pozita jonë që e paraqitëm në negociatë**

së dhe identitetit të saj nacional dhe nga ana tjetër pala greke nuk e zbut qëndrimin për përdorimin e emrit 'erga omnes', nuk ka asnjë siguri se Maqedonia mund të merr ftesë për anëtarësim në NATO në Samitin e radhës në Strasburg, thotë Pajaziti.

"Ndryshimi i emrit kushtetues është sfidë e ardhshme e Maqedonisë, prej të cilës varet anëtarësimi i saj në NATO dhe fillimi i negociatave me Bashkimin Evropian. Para Samitit të ardhshëm të NATO-s, lidhshipi dhe Akademia e Shkencave Maqedonase medoemos duhet t'i nënshtrohen rishikimit të historisë dhe identitetit të tyre. Në këtë drejtim, edhe pala greke duhet të zbusë qëndrimin për përdorimin e emrit 'erga omnes' gjatë procesit të negociatave, të cilat deri më tani janë zhvilluar në Uashington, Athinë dhe Shkup. Nëse nuk ka lëvizje në këtë drejtim, nuk do të ketë asnjë siguri se Maqedonia do të marrë ftesë për anëtarësim në Samitin e radhës në Strasburg", thekson Pajaziti. Ai është kritik ndaj diplomacisë maqedonase, e cila nuk ka inkuadruar asnjë përfaqësues shqiptar në procesin rreth emrit. Në

rast të kundërt, Muhamer Pajaziti, mendon se përfshirja e shqiptarëve do të kontribuonte shumë në zgjidhjen e problemit.

#### SHBA, BRUKSELI DHE OKB TË JETË GARANCA E MARRËVESHJES

"Në këtë cikël negociatash, është për çudi dhe bie në sy një fakt, se si diplomacia maqedonase nuk përfshiu as edhe një komunitet etnik shqiptar në këtë proces. Palë, e cila do të kontribuonte shumë në zgjidhjen e problemit, sepse sipas fakteve historike - në mënyrë direkte apo indirekte shqiptarët janë të lidhur me ngushtë me emrin, sepse kanë jetuar në periudhën e shtetit të lashtë me emrin Maqedonia, përderisa maqedonasit as nuk kanë qenë prezentë në këto territore. Sidoqoftë kjo situatë dëshmon vazhdimësinë e anashkalimit të shqiptarëve në proceset vendimmarrëse. Shqiptarët në politikën e jashtme të Maqedonisë akoma shërbejnë vetëm si mekanizëm për të votuar marrëveshjet dhe deklaratat e "fqinjësisë së mirë" që hartojnë maqedonasit me vendet fqinje në prag të integriteteve euroatlantike", thekson Pajaziti. Ish ministri i Punëve të Jashtme, Nano Ruzhin, thekson se përveç ndryshimit të Kushtetutës, marrëveshja bilaterale mes dy vendeve me mbështetje të BE-së, OKB-së dhe SHBA-ve, do të ishte zgjidhja më e mirë afatgjatë dhe siguri që Maqedonia të anëtarësohet në NATO. "Emri është gjetur, a bëhet fjalë për Maqedoni Veriore ose të Epërme, tashmë ekziston konsensus për këtë çështje. Problemi tani qëndron tek garancat që të dyja palët, e në veçanti pala greke i kërkon se vallë, Maqedonia do ta respektojë emrin e ri të vendit.

#### IBRAHIM MEHMETI

**Për momentin, është e qartë se qeveria nuk e ka përgatitur opinionin për pranimin e një emri të ri edhe për përdorim të brendshëm, gjë që padyshim e bën zgjidhjen e çështjes se emrit edhe më të komplikuar. Mbetet të shihet nëse kjo çështje do të tentohet të zgjidhet ndoshta me referendum ose në ndonjë formë tjetër, por në çdo rast, është e domosdoshme që opinioni i brendshëm të përgatitet për një zgjidhje të këfillë**

#### MUHAMER PAJAZITI

**Në këtë cikël negociatash, është për çudi dhe bie në sy një fakt, se si diplomacia maqedonase nuk përfshiu as edhe një përfaqësues të komunitetit etnik shqiptar në këtë proces. Palë, e cila do të kontribuonte shumë në zgjidhjen e problemit, sepse sipas fakteve historike - në mënyrë direkte apo indirekte shqiptarët janë të lidhur me ngushtë me emrin, sepse kanë jetuar në periudhën e shtetit të lashtë me emrin Maqedonia, përderisa maqedonasit as nuk kanë qenë prezentë në këto territore**

Për këtë arsye, të dyja palët kërkojnë para qytetarëve garanci për ndryshime Kushtetuese. Por kjo për mendimit tim nuk është garanci e sigurt, garanca më e sigurt është marrëveshje bilaterale midis dy vendeve, e cila do të mbështetet normalisht nga Kombet e Bashkuara, SHBA-ve dhe Brukselit", thotë ish-ambasador Ruzhin.

Ndryshe zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa resor, Dimitris Xanakopoulos, në qëndrimin tij të fundit për çështjen e emrit vë në pah kushtin që Maqedonia të pranojë ndryshimin e Kushtetutës. "Është e nevojshme marrëveshje ku qartazi do ti përshkruante hapat e zgjidhjes. Ndryshim të emrit në marrëdhëniet ndërkombëtare, pastaj ndryshim të Kushtetutës të IRJM-së, dhe pastaj vjen mbështetja e Greqisë për integrim të fqinjët në gjitha organizatat ndërkombëtare. Kjo është pozita jonë që e paraqitëm në negociatë", ka thënë Xanakopoulos.

Barber thotë se ardhmja e një ujdje Maqedoni-Greqi është e pasigurt, pasi Athina kërkon ndryshimin e Kushtetutës, kurse Shkupi mendon për një zgjidhje në dy forma, një për përdorim të jashtëm, dhe një për përdorim të brendshëm

Shkup, 8 maj - Përmes redaktorit për Evropë, Tony Barber, prestigjiozja amerikane "Financial Times" shkruan se e ardhmja e brishtë e Ballkanit varet nga marrëveshja e Maqedonisë me Greqinë. Sipas tij, ndryshimet e emrit të aeroportit dhe të një auto udhe, nga siç thotë "leadershipi reformator" paraqesin shpresë për rajonin e Ballkanit.

Në analizën e tij, Barber konsideron se një ujdi që do ta përmblyte çështjen mbi 20 vjeçare të emrit, do të ishte sinjal pozitiv për vendet tjera si Kosova e Serbia, apo edhe kroatët, muslimanët e serbët në Bosnjë e Hercegovinë. Gjithashtu, Barber konsideron se ujdja për emrin do të hapte dyert e BE-së dhe NATO-së për Maqedoninë dhe këtë vend do ta largonte nga paqëndrueshmëria gjeopolitike, dhe se do të ishte një kundërvënie për zgjerimin e prezencës në Ballkan të Rusisë, Turqisë, Kinës, Arabisë Saudite dhe vendeve tjera të Gjirit. Barber citon deklaratën e Ali Ahmetit të ketë thënë se gjithçka që është arritur me marrëveshjen e vitit 2001 do të ishte e kotë nëse

"FINANCIAL TIMES" PËR KONTESTIN E EMRIT

# E ARDHMJA E BALLKANIT VARET NGA MARRËVESHJA GREQI-MAQEDONI



nuk anëtarësohet Maqedonia në NATO dhe BE.

Megjithatë, Barber thotë se e ardhmja e një ujdje Maqedoni-Greqi është e pasigurt, pasi që

Athina kërkon ndryshimin e Kushtetutës, kurse Shkupi mendon për një zgjidhje në dy forma, një për përdorim të jashtëm, dhe një për përdorim të brendshëm. Këtë qën-

drim, Barber e bazon edhe në faktin se në Qeverinë e Tsipras ka një parti nacionaliste, dhe kësaj i shtohet opozita konservatore, Kisha Ortodokse, përfshi tentimet e Ru-

sisë për të penguar një ujdi të mundshme, ndërsa zgjedhjet e vitit të ardhshëm mund të ngritin temperaturat politike, dhe kjo dëmton bisedimet. Në përmblyje për "Financial Times", Tony Barber konsideron se jo të gjitha shtetet e BE-së dhe të NATO-së e shohin anëtarësimin e Maqedonisë si diçka parësore, por kjo do të mësohet në samitin e BE-së në qershor, dhe të NATO-së, në korrik.

Ai shprehet se këto samite mund të jenë tepër të parakohshme për një ujdi Maqedoni-Greqi, dhe nëse kjo është kështu, atëherë Barber shpreson se NATO dhe BE t'i rezistojnë tundimit për pengesa, si një arsyetim për anashkalimin e çështjes së Maqedonisë, dhe se "Ballkani është tepër i brishtë që të lejohen vetëkënaqësi të tilla".

## DIASPORA GREKE I KËRKON KOXIASIT NDËRPRERJE TË NEGOCIATAVE

"Lidhjet mbarëmaqedonase nga bota" greke, në një korrespondencë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme Nikos Koxias kërkojnë ndërprerje të negociatave për emrin. Siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, bëhet fjalë për organizata greke të cilat ishin pjesë e organizatorëve të protestave në Selanik dhe në Athinë për "mbrojtje të emrit të Maqedonisë". "Menjëherë duhet të ndërpriten negociatat dhe të ndaloni ta poshtëroni dinjitetin e grekëve në

tërë botën, me tërheqjen dhe me insistimin tuaj për t'ua dhënë emrin Maqedoni robërve të Shkupit", i shkruajnë Koxiasit dhe thonë se ai ka për obligim ta marrë parasysh vendimin nga takimi i liderëve në vitin 1992 dhe mosmarrëveshjet e popullit grek për ekzistimin e emrit Maqedoni në emrin e "shtetit fqinj qendror-ballkanik". Në shkrim thuhet se, sipas informacioneve të publikuara "është e qartë se negociatat kanë arritur në qorrrosak" për shkak

të mospranimit të erga omnes emrit dhe ndryshimit kushtetues nga ana e Maqedonisë. "Nuk ekziston asnjë arsye. Ju, duke e prezantuar palën greke, në mënyrë poshtëruese të lutni të vazhdojnë negociatat kur tani më keni bërë lëshime të dhimbshme dhe të pasakta historike, duke pranuar emër të ndërlikuar i cili e përmban termin Maqedoni", i shkruajnë Koxiasit nga "Lidhjet mbarëmaqedonase nga bota".

AMBASADORI RUS ZBUT FJALORIN

## Duam marrëdhënie të mira me Maqedoninë



Prilep, 8 maj - Sinqerisht dëshirojmë që marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Federatës ruse të përparohen në mënyrë të suksesshme, konstruktive, në frymën e bashkëpunimit, mirëkuptimit të përbashkët dhe barazisë. Rusia po tenton të bëhet partner i mirë, ndërsa si do të silllet Maqedonia, kjo është e drejtë e saj sovranë, deklaroi ambasadori i Federatës Ruse në Maqedoni, Oleg Shcherbak gjatë vizitës së tij në Prilep, i pyetur që t'i vlerësojë marrëdhëniet momentale ndërmjet dy vendeve. "Rusia dhe Maqedonia janë dy shtete mike të cilat janë të lidhura me lidhje historike dhe shpirtërore

shekullore. Në pjesë të madhe kemi kulturë të përbashkët, në pjesë të madhe edhe gjuhë të përbashkët, rrënjë të përbashkëta shpirtërore. Sinqerisht dëshirojmë marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Federatës ruse të përparohen në mënyrë të suksesshme, konstruktive, në frymën e bashkëpunimit, mirëkuptimit të përbashkët dhe barazisë. Në marrëdhëniet ndërkombëtare janë shumë të rëndësishme marrëdhëniet bilaterale, ndërsa kjo është si rrugë me dy drejtime. Si edhe për një tango të mirë, janë të nevojshme përpjekjet e të dyja palëve. Rusia tenton të jetë partner i mirë, ndërsa se si silllet Ma-

qedonia, kjo është e drejtë e saj sovranë", tha Shcherbak. Ambasadori Shcherbak i hodhi poshtë si gënjeshtër propaganduese akuzat se Rusia përfshihet në disa pjesë të Ballkanit që të mos hynë në NATO si dhe në kontestin për emrin ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. "Në botën bashkëkohore prodhohen shumë gënjeshtër. Ky është shembull klasik i gënjeshtërve propaganduese. Nuk kam për qëllim të hap të vërtetë për këto gënjeshtër, ndërsa në të gjitha këto pyetje u përgjigja të shtunën e kaluar në një artikull në një gazetë", deklaroi Shcherbak. Sa i përket asaj se a gjendet bota afër luftës së re të ftohtë", Shcherbak tha se kjo nuk është në iniciativë të Rusisë. "Rusia bën gjithçka që ta zvogëlojë nivelin e tensioneve në botë dhe vepron që ta ndalojë atë propagandë të tmerrshme antiruse e cila përhapet në botë. Bëjmë gjithçka që këto tentativa që të fillohet një luftë e re e ftohtë të shuhet dhe të mos kalojnë në luftë të "nxehtë", tha ambasadori i Federatës Ruse në Maqedoni Oleg Shcherbak gjatë shënimit të sotëm në Prilep të 9 Majit - Ditës së fitores ndaj fashizmit.

## MPB ka kontroll në tërë territorin e Maqedonisë

Ohër, 8 maj - Ministria e Punëve të Brendshme ka kontroll ndaj tërë territorit të Republikës së Maqedonisë, këtë e kemi dëshmuar shumë herë, që është konfirmuar me të gjitha kontrollet dhe aksionet e zbatuara vitin e kaluar, në mënyrë joselektuese, në cilin do qytet të vendit, deklaroi ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Spasovski, i cili në Ohër mori pjesë në punën e Konferencës shkencore ndërkombëtare të shërbimeve për sigurimin e VIP personave dhe objekteve, si ministër nuk ka dashur të japë vlerësim për atë sa nga dokumentet senzitive të sigurimit do të jenë të disponueshme për Xhezair Hoxhën si këshilltar për sigurimit të kryeministrit Zoran Zaev. "Për atë se çka do të ketë në dispozicion këshilltari, do të kërkon informacion nga Qeveria", deklaroi ai. Megjithatë, në cilësi të funksionarit të lartë të LSDM-së ai tha se nëse shikohet më thellë shumë emra kontraversë e udhëheqin RM-në dhe nga viti 2002 marrin pjesë në jetën politike në shtet. "Pyetja është çka është aq kontraverse. Nëse do të kishim situatë të konfliktit ushtarak të shkaktuar para së gjithash ajo që ndoshta nuk do të kishim sens të mjaftueshëm për integrim në çdo njeri në shoqëri, atëherë duhet të jemi pragmatikë gjatë sjelljes së vendimeve. Mendoj se në kushte të tilla pragmatizmi është shumë i rëndësishëm për përmirësimin e të gjitha aspekteve të jetës shoqërore. Nuk shikoj arsye pse pozitivisht nuk do të vlerësohet çdo përfshirje e njerëzve të cilët dëshirojnë të punojnë në RM. Me të vërtetë do të isha i shqetësuar nëse ka njerëz të cilët nuk dëshirojnë të përfshihen ndaj institucioneve të sistemit, të cilët dalin jashtë tyre, nuk dëshirojnë të jenë pjesë e shërbimeve të sigurimit, ministrive, Qeverisë. Atëherë duhet të gjithë ne të mendojmë edhe qytetarët edhe mediat edhe institucionet, pse do t'i braktisin institucionet dhe nëse e bëjnë këtë, çka do të bënin", tha Spasovski.

PARREGULLSITË ZGJEDHOR NË ÇAIR ASSESI TË SHQYRTOHEN

# "TITANIK 3" ANULOHEM PËR TË TRETËN HERË



Seanca e tretë me radhë kundër Alimit dhe Gurit u prolongua për shkak se gjykatëses Gordana Spirovska, njëherësh anëtare e Këshillit Penal, gjatë zhvillimit të këtij procesi gjyqësor, bashkëshorti i kishte pësuar sulm në tru

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 8 maj - Praktika e shpeshtë me prolongimin e seancave gjyqësore në rastet ku Prokuroria Speciale Publike paraqitet si përfaqësuese e aktakuzës ka vazhduar edhe në procesin gjyqësorin për rastin "Titanik 3". Ndonëse në Gjykatën Penale të Shkupit të martën pritej të fillojë përfundimisht gjykimi kundër Ejup Alimit dhe Ismet Gurit, që të dy funksionarë të BDI-së, megjithatë edhe kësaj radhe shqyrtimi i parregullive të procesit zgjedhor të vitit 2013 në Çair nuk u procedua. Vendimit për anulimin e seancës në rastin "Titanik 3", të martën i parapriu kërkesa e avokatit

Elenko Millano i cili në cilësinë e palës mbrojtëse të Ismet Gurit, nga gjykatësja Olja Ristova kërkoi shkarkimin e prokurorës Katica Janeva nga ky rast.

"Prokurorja Katica Janeva, si shtetase e Maqedonisë dhe shfrytëzuese e mjeteve buxhetore, mund të llogaritet si palë e dëmtuar në këtë proces. Njëherit, lidhur me këtë lëndë paraprakisht nga PSP ka qenë i miratuar një vendim për ndërprerjen e procedurës hetimore kundër Blerim Muhaxherit dhe Qani Toçit, të cilët më pas janë bërë dëshmitarë. Me ndërprerjen e kësaj procedure, vihet në dyshim serioz veprimi i paanshëm i prokurorëve në këtë lëndë", tha avokati Elenko Millano. Ndaj kësaj kërkesë reagoi prokurori special Gavril Bubeski, sipas të cilit, ky propozim i palës mbrojtëse duhet të refuzohet pasi Ligji special çdoherë qëndron mbi dispozitat e Ligjit të rëndomtë.

"Kur është miratuar Ligji për PSP-në, ligjvënësi nga arsye të cilat i ka pasur parasysh, e ka mënjanuar mundësinë për shkarkimin e prokurorit special në procedurë gjyqësore. Për këto arsye, kërkesa e palës mbrojtëse nuk ka bazë, gjegjësisht nuk ekziston organ kompetent i cili mundet ta shkarkojë prokurorinë speciale", tha prokurori Bubeski.

Seanca e tretë me radhë kundër Alimit dhe Gurit u prolongua për shkak se

gjykatëses Gordana Spirovska (anëtare e Këshillit Penal) gjatë zhvillimit të këtij procesi gjyqësor bashkëshorti i kishte pësuar sulm në tru. Procedimi i lëndës "Titanik 3" me vendim të GJPSH-së është caktuar të mbahet më datë 11 maj, kur edhe pritet të dihet se vallë do të këtë ndryshime në Trupin gjyqësor ose i njëjti do të vazhdojë me përbërjen e njëjtë. Ndryshe, siç njoftuan më parë të akuzuarit, kundër tyre në këtë proces gjyqësor pritet të paraqiten mbi 40 dëshmitarë. Në bazë të aktakuzës së PSP-së, dy funksionarët aktual të BDI-së, deputeti Ejup Alimi dhe funksionari i DAP-it, Ismet Guri, pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në Çair, në vitin 2013, kanë kryer një varg parregullsish gjatë përgatitjes së procesverbaleve. Shtimi i votave në favor të BDI-së dhe dëmtimi i partisë opozitare, në këtë rast PDSH-së, paraqesin veprimet kryesor, të cilat PSP-ja i heton në rastin "Titanik 3". Në përgjithësi, rastet të koduar me emrin "Titanik" lidhen me shkeljet edhe parregullsitë zgjedhore, respektivisht "Titanik 1" zhvillohet kundër 21 të akuzuarve, kryesisht ish-funksionarë të lartë të VMRO-DPMNE-së dhe "Titanik 2" kundër Menduh Thaçit dhe Sasho Mijallkovit, për ndikimin e tyre deri te anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

## KRONIKË

### Bie nga skela, lëndohet 38-vjeçari nga Çegrani

Një punëtor ndërtimor është lënduar rëndë si pasojë nga rrëzimi nga skela gjatë kryerjes së punëve ndërtimore në fshatin Forinë të Gostivarit. Sipas SPB Tetovë, mbrëmë rreth orës 19 gjatë çmontimit të skelës ndërtimore, J.Ç. (38) nga Çegrani, i punësuar në firmën e cila i ka kryer punët në objekt, ka humbur kontrollin dhe ka rënë nga platforma e fundit.

Menjëherë pas rrëzimit, ai është transferuar në Spitalin e Përgjithshëm të Gostivarit, prej ku për shkak të seriozitetit të lëndimeve është transferuar në Qendrën Urgjente Shkup. Pas aksidentit, ekspertizë ka kryer ekipi i SPB-së Tetovë dhe inspektori për punë, siguri dhe shëndet. Në vijim janë masat për ndriçimin e rastit dhe rrethanave nën të cilat është lënduar punëtori.

### Arrestohet 32-vjeçari, i gjetën marihuanë

Pjesëtarë të Policisë së Tetovës të hënë kanë arrestuar 32-vjeçarit me iniale A.A nga fshati Shemshovë. Sipas policisë, ai është arrestuar në Tetovë në mesditë, ndërsa gjatë kontrollit të detajuar, në xhep i kanë gjetur një qese plastike me marihuanë dhe afër tij po ashtu janë gjetur edhe dy paketime më të mëdha. Marihuana e gjetur është fotodokumentuar dhe është marrë për ekspertizë. Pas zbardhjes së rastit, kundër personit A.A. do të inicohen padi adekuate.

### 40-vjeçarja nga Strumica vdes në Gostivar

Një 40-vjeçare me iniale K.T nga Strumica ka ndërruar jetë të hënë mbrëmë në Spitalin e Përgjithshëm në Gostivar. Sipas policisë, ajo përkohësisht ka qëndruar në Gostivar dhe pas mesnate ka kërkuar ndihmë mjekësore. Menjëherë, gjendja shëndetësore e saj është përkeqësuar dhe për një kohë të shkurtër, K.T. ka ndërruar jetë. Prokurori publik dhe ekipi i stacionit policor nga Gostivari kanë kryer ekspertizë dhe ndaj trupit të pajetë të K.T. do të kryhet obduksion.

### Aksidentohet 65-vjeçari nga Tenova

Të hënë rreth orës 17.00, personi F.J. 65 vjeç nga fshati Tenovë duke lëvizur me biçikletën e tij nëpër rrugën lokale prej fshatit Pirok, në drejtim të autostradës Gostivar-Tetovë, nga shkaqet të panjohura i njëjti është rrëzuar nga biçikleta dhe ka marrë lëndime në kokë. Me veturë është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku pas dhënies së ndihmës mjekësore, është dërguar në Klinikat e Shkupit. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit, shkaqet e rrëzimit, dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur rasti etj

### Dy të lënduar në aksident trafiku

Të hënë rreth orës 12.30 minuta, në rrugën lokale Tetovë-Falishtë në afërsi të mbikalimit të autostradës Tetovë-Shkup, ka ndodhur aksident trafiku në të cilën pjesëmarrës kanë qenë vetura "Ford Ka" me targa të Gostivarit, e drejtuar nga 22 vjeçari V.I. nga Tetova dhe një motoçikletë "Honda", me targa të Shkupit, e drejtuar nga 23 vjeçari F.Q. nga fshati Pallçisht i Epërm. Në aksident, motoçiklisti F.Q. dhe bashkudhëtari i tij 26 vjeçari B.L nga Tetova, kanë marrë lëndime trupore, janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku pas dhënies së ndihmës mjekësore, janë ndaluar për mjekim të mëtutjeshëm. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes, dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

## Shkup, 13 aksidente me një të vdekur

Shkup, 8 maj - Një bashkudhëtar në automjetin motorik të udhëtarëve e ka humbur jetën, ndërsa një person është lënduar rëndë në dy nga gjithsej 13 aksidente që kanë ndodhur gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në katër aksidente, lëndime të lehta trupore kanë marrë gjashtë persona, ndërsa në shtatë është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dhe sanksio-

nuar një numër më të madh kundërvajtjesh. Gjashtëdhjetë e katër vozitës kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, tre vozitës ka kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, tre vozitës nuk u kanë dhënë përparësi kalimi, një shofer për reshtim jo të rregullt dhe një vozitës i motoçikletës për mos shfrytëzim të helmetës. Është sanksionuar edhe një këmbësor i cili ka kaluar jashtë kalimit për këmbë-

sorë. Janë hasur 128 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Nga komunikacioni janë përjashtuar shtatë vozitës të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 15 vozitës para se të përfitohen me të drejtën e vozitjes dhe tre vozitës fillestarë, si dhe një automjet teknikisht të parregulluar dhe 15 të paregjistruara. Me ndihmën e karrotrecit, janë mënjanuar 79 automjete.

SELEKSIONIMI PËR PARALELEN E TENISIT VETËM NË QYTETE MAQEDONASE

# "AKADEMIA SPORTIVE" LARG SHQIPTARËVE

Thuajse të gjitha paralelet e SHMSH "Akademia Sportive" të formuara deri tani janë në gjuhën maqedonase, ndërsa pritet që ai raport të thellohet dhe më tej në disfavor të shqiptarëve për vitin shkollor 2018/2019. Përfundimisht kryeqytetin, të gjitha seleksionimet tjera për fazën paraprake janë realizuar në qytete me shumicë maqedonase



le të Gjimnazit Sportiv "Metodia M. Brico" në Shkup dhe më pas me pavarësimin e këtyre paraleleve në Shkollë të Mesme Shtetërore, nga vitin 2015/2016. Në fakt, me themelimin e "Akademisë Sportive" u thellua hendeku edhe ashtu i krijuar në këtë lloj shkollimi në gjuhën shqipe. MASH ka lejuar formimin e paraleleve të para të gjimnazit sportiv në gjuhën shqipe në "Metodia M. Brico" jo më larg se 12 viteve. Deri në vitin shkollor 2012/2013 formoheshin nga tre paralele në gjuhën shqipe. Mirëpo me hapjen e paraleleve të Akademisë Sportive, në fillim si eksperimentale dhe pastaj si pavarura në hapësirat e Gjimnazit Sportiv "Metodia M. Brico" u ngushua hapësira për këtë lloj shkollimi në gjuhën shqipe.

Zvogëlimi i paraleleve shqipe, ndodhi jo vetëm sepse paralelet e "Akademisë sportive" janë kryesisht në gjuhën maqedonase, por dhe sepse me vendosjen e Akademisë në hapësirat e Gjimnazit "Metodia M. Brico" u zvogëluar mundësitë për formimin edhe të paraleleve të gjimnazit sportiv. Disa vite me radhë, është ulur në dy numri i paraleleve shqipe edhe në këtë gjimnaz. Sidoqoftë, seleksionimi final i kandidatëve për paralelen e tenisit për vitin shkollor 2018/2019 do të mbahet në Shkup, në datën 18 maj, Kandidatët duhet të bëjnë paraqitjet në njësitë ku kanë bërë paraqitjet e fazës paraprake.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 8 maj - E themeluar prej para tre viteve, me statutin e Shkollës së Mesme Shtetërore "Akademia Sportive" synon të zgjerojë gamën e disiplinave në të cilat do të formohen paralele për vitin shkollor 2018/2019. Krahas paraleleve të futbollit, basketbollit dhe hendbollit, pritet që nga shtatori i këtij viti të formohet edhe paralelja e tenisit. Kjo, me qëllim që Akademia Sportive t'ju mundësojë nxënësve të talentuar sportiv që të aftësohen për arritjen e rezultateve të larta spor-

tive dhe që të bëhen anëtarë të kombëtareve të futbollit, basketbollit, hendbollit dhe tenisit që moshë të re, sikurse thuhet në Thirrjen publike për verifikimin e aftësive dhe dhuntive sportive të nxënësve që janë të interesuar të regjistrohen në SHMSH "Akademia sportive", në paralelen e tenisit. "Nxënësit do të kenë përkujdesje të veçantë, speciale për këtë qëllim, program të përpunuar për arsim dhe trajnim. Për punën me nxënësit do të angazhohen ekipe profesionale të përbërë nga trajneri, zëvendësi i tij dhe fizioterapeuti", thuhet mes tjerash në aty, ndërsa verhet se prani

mi bëhet me seleksionim.

"Kandidatët për regjistrim në vitin e parë të shkollës së mesme në këtë paralele të seleksionohen nga ana e komisionit profesional", qëndron në Thirrje publike të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Por edhe në këtë rast nuk mungon anashkalimi i shqiptarëve. Në përjashtim të një paralele futbollit në Tetovë, të gjitha paralelet tjera të SHMSH "Akademia Sportive" që janë formuar deri tani, janë në gjuhën maqedonase. Ndërkaq, në përpjekje për formimi e paraleles së tenisit, duket se ky raport do të thellohet edhe më shumë. Përfundimisht

to kryeqytetin, të gjitha seleksionimet tjera, të fazës paraprake janë realizuar në qytete me shumicë maqedonase. Në listën e qyteteve ku javën e kaluar u bënë seleksionimet e fazës së parë munguan qytete me shumicë shqiptare si Tetova, Gostivari, Struga, Dibra, Kërçova apo Kumanova. Seleksionimet paraprake të kandidatëve për paralelen e tenisit u organizuan ekskluzivisht në Shkup, Manastir dhe Shtip. Kjo, nuk është hera e parë që Akademia Sportive sfidon shqiptarët. Kështu është vepruar në mënyrë sistematike prej vitit 2013 ku ato paralele u formuan si paralele eksperimentale

Zero hapësira për pajisje kompjuterike, pa leximore dhe me vetëm nga një bibliotekë rezultojë të jenë Universiteti "Nënë Tereza" më Shkup dhe Universiteti "Apostol Pavle" në Ohër. Por, në bazë të regjistrimit të institucioneve të arsimit të lartë që ka bërë ESHS për vitin 2017, nuk është në gjendje kushedi sa më të mirë edhe Universiteti i Tetovës, nëse e krahasojmë me Universitetin "Kirili dhe Metodi" të Shkupit. Ky i fundit për shembull ka 3956 metra katrorë për hapësira kompjuterike, ndërsa UT ka 294 metra katrorë për të njëjtin qëllim

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 8 maj - Regjistrimi i objekteve, hapësirave të studimit dhe shërbimeve përcjellëse që posedojnë institucionet e arsimit të lartë, i kryer vitin e kaluar nga ana

NDARJA E PA BARABARTË E HAPËSIRAVE UNIVERSITARE

## UNIVERSITETET PA LEXIMORE

e Entit Shtetëror të Statistikave, ka treguar se në Maqedoni ka ende universitete që kanë mungesa të theksuara të këtyre hapësirave. Shpërndarja e tyre është gjithashtu disproporcionale - gjë që bën të mos kenë kushte dhe hapësira të barabarta shkollimi për të gjithë. Kështu, nga 101 objekte në dispozicion me 1894 hapësira dhe me gjithsej 141.025 metra katrorë, pjesën më të madhe e disponojnë institucionet publike edhe atë: 81 objekte, 1488 hapësira mësimi që zënë një sipërfaqe prej 107.957 metrkatrorë. Rreth 17 objekte me 388 hapësira dhe 31.878 metra katrorë u takojnë privatëve, ndërsa 2 objekte me 18 hapësira dhe 1.190 metra katrorë institucioneve fetare. Kështu, shtetërorët posedojnë 81.2 për qind të hapësirës akademike për dallim prej privatëve me 18.8 për qind dhe institucionet fetare 2 për qind.

Mirëpo, edhe te pjesa e hapësirave të institucioneve me karakter publik vërehen dallime të theksuara nga universiteti në universitet, të cilët shkojnë deri në ekstreme. Për shembull, edhe pse universitetet me karakter publik, konkretisht universiteti shtetëror "Apostol Pavle" në Ohër dhe Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, nuk posedojnë fare hapësira me pajisje kompjuterike dhe leximore. Sipas të dhënave për Regjistrimin e institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoni, në vitin 2017, UAP dhe UNT nuk kanë asnjë metër katrorë hapësira kompjuterike dhe asnjë leximore, ndërsa posedojnë vetëm nga një bibliotekë, i pari me 56 metër katrorë dhe e dyta me 20 metra katrorë. Universiteti i Tetovës ka 4 hapësira me pajisje kompjuterike (me 294 metra katrorë) katër biblioteka me 237 metra katrorë dhe dy leximore me 187 metra katrorë.

Universiteti "Kirili dhe Metodi" në Shkup, i cili ka pjesën më të madhe të hapësirave të studimit, po sipas ESHS-së, ka 30 hapësira me pajisje kompjuterike me gjithsej 3956 metra katrorë, 29 biblioteka me 5272 metra katrorë dhe 14 leximore me 2958 metra katrorë. Por përtej këtyre hapësirave, që janë më tepër standarde me karakter shoqëruar, dallimet janë të mëdha edhe në hapësirat e amfiteatrove dhe klasave apo kabineteve ku zhvillohen ligjëratat dhe ushtrimet. Kështu, në këtë pikë universitetet shtetërore në përgjithësi posedojnë 75.4 për qind të amfiteatrove dhe 77.6 për qind të klasave. Por nëse i analizojmë veçmas universitetet shtetërore, të krahasuara njëra me tjetrën, i bie që gati gjysma e atyre hapësirave janë të UKM-së. Konkretisht, ky universitet ka 58 amfiteatro nga 108 që kanë të gjitha universitete shtetërore edhe

atë me 8712 metra katrorë nga 16.132 metra katrorë gjithsej, ndërsa ka 239 klasë (14.820 metra katrorë) nga gjithsej 485 (28.255 metra katrorë).

UT ka 18 amfiteatro me 2434 metra katrorë, si dhe 96 klasë me 4228 metra katrorë. Ndërsa UNT i ka ende më të papërfillshme performacat në këtë pikë. Regjistrimi i vitit të kaluar ka treguar se ky universitet disponon vetëm 2 amfiteatro me 177 metra katrorë dhe 3 klasa me 140 metra katrorë. Nëse i krahasojmë universitetet në gjuhën shqipe, si atë të Tetovës ashtu edhe këtë të Shkupit, do të biem në përfundim se qëndrojnë shumë larg UKM-së. Sepse, nëse ky i fundit ka në total 63.286 hapësirë universitare, UT ka po në total 13.076 metra katrorë, ndërsa UNT ende më pak, vetëm 1667 metra katrorë hapësirë të përgjithshme universitare.

## PARALAJMËROHEN PROTESTA PARA KOMUNËS SË TETOVËS

"Pas protestës së ditës së premte neve nuk na ka kontaktuar askush. Nuk është ndërmarrë asnjë masë që kazinoja të mos hapet dhe të ndërpriten punët përgatitore. Vazhdimin e punëve e marrim si provokim. Ne si banorë të lagjes, por edhe opinioni që na mbështet jemi të habitur me mos reagimin e institucioneve relevante dhe heshtjen e tyre", thotë Emurllai



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 8 maj - Kazinoja në Reçicë të Vogël vazhdon të mbushet me aparate e me arka. Ne videon e cila është bërë virale në rrjetet sociale shihen se si disa persona fusin aparate në objektin për të cilin thuhet se do hapet kazino. Organizatorët e protestave kanë theksuar se kjo është e paprueshme ngase edhe përkundër revoltës së qytetarëve, megjithatë kazinoja vazhdon të bëhet gati për hapje. Jushi Emurllai një nga organizatorët e kësaj proteste, nënvizon se edhe pse kanë patur premtime që të mos hapet kazinoja deri në arritjen e një marrëveshje që të mos punohet, kjo nuk është respektuar. "Pas protestës së ditës së premte neve nuk na ka kontaktuar askush. Nuk është ndërmarrë asnjë masë që kazinoja të mos hapet dhe të ndërpriten punët përgatitore. Vazhdimin e punëve e marrim si provokim. Ne si banorë të lagjes, por edhe opinioni që na mbështet jemi të habitur me mos reagimin e institucioneve relevante dhe heshtjen e tyre", thotë Emurllai. Ai sqaron se Kë-

## KAZINONË NË REÇICË S'KA KUSH E NDALË

shilli organizativ ka marrë informacione se tek kazinoja punohet që e njëjta të hapet pikërisht në lagjen ku dikur mbanin mësim studentët e Universitetit të Tetovës. "Dikur në këtë lagje kanë mësuar studentët nëpër shtëpi private dhe sot në këtë lagje hapet kazino. Këtu janë afër dy universitete, shkollat e mesme dhe fillore. Nxënësit apo studentët më afër e kanë kazinonë se shkollën apo objektin e Universitetit. Jemi të indinjuar që në këtë mënyrë vazhdohet me ngulm që të hapet kjo kazino. Ne nuk kërkojmë mbylljen e kazinove jashtë qytetit, por në brendi dhe afër shkollave apo institucioneve tjera, sepse ne nuk jemi faktor që të mbyllem kazino, por shteti

duhet ta bëjë", deklaroi ai. Në ndërkohë, sipas tij, protestat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen kundër hapjes së kazinove dhe se kërkesa e tyre është që e njëjta të mos hapet në këtë pjesë të qytetit. "Apeloj që qytetarët dhe opinionin të na përkrah në këtë rrugëtim tonin edhe në të ardhmen. Kemi marrë shumë përkrahje, por presim që në të ardhmen të kemi protesta dhe revoltë më të madhe. Po ashtu revoltën do të shprehim edhe para Komunës së Tetovës, ndërsa për kohën do të informojmë opinionin", u shpreh Emurllai. Sipas informacioneve, pronar i kazinოსë figuron një person nga Strumica, ndërsa punëtorët janë nga Shkupi. Po ashtu përfillet se në dokumentet zyrtarë

figuron se emri i kazinოსë ka qenë Universiteti, por pas reagimeve është larguar ky emër. Një nga kërkesat bazë të organizatorëve të protestave është që këta objekte të lojërave të fatit të jenë tre kilometra larg institucioneve arsimore dhe publike. "Ne u jemi drejtuar Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë të të Hyrave Publike dhe Komunës së Tetovës. Të anulojnë punën për hapjen e kësaj kazinove, nën dy të hartojnë një ligj që gjitha kazinotë, bastoret sportive dhe lojërat tjera të fatit të largohen së paku 3 kilometra nga shtëpia e fundit e çdo vendbanimi", theksuan nga Këshilli organizativ.

## Në korrik marrëveshjet e para për shtyllën e tretë

Shkup, 8 maj - Më shumë se 100 kompani deri më tani kanë ngritur aplikime projektuese për mjetet nga shtylla e tretë të Planit qeveritar për rritje ekonomike. Deri në fund të thirrjes pritet dyfishimi i këtij numri, ndërsa në fillim të korrikut edhe nënshkrimi i marrëveshjeve të para, deklaroi sot drejtori i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik Jovan Despotovski. Thirrja publike e projektuar në 645 milionë denarë ishte shpallur më 28 prill, ndërsa do të zgjasë deri më 11 qershor. Tani për tani interes më të madh ka për masën e tretë - shpenzime financiare deri në 60 për qind për inovacione, produkte dhe shërbime të reja, nga ideja deri te plasmani, për çfarë janë paraparë 20 milionë denarë, dhe në këtë segment janë tre të katërtat e firmave të cilët kanë aplikuar. Kompanitë janë të interesuara edhe për masën e katërt - aftësim profesional të rinjve deri më 29 vjet në disa nga kompanitë në vendet perëndimore. "Interesi është i madh. Pres deri në fund të thirrjes të kemi 150-200 kompani të paraqitura që tregojnë se ekonomia e Maqedonisë dhe format vendore kanë nevojë për një lloj të mbështetjes dhe masave të këtu. Gjithashtu, pres deri në fund të vitit t'i ndajmë të gjithë mjetet", thekson Despotovski para info-sesionit për aplikimet projektuese në Odën Ekonomike të Maqedonisë. Sipas tij, transparencja do të jetë maksimale gjatë përzgjedhjes së projekteve dhe vendimin i cili do të financohet. "Në fazën e parë, evaulimin e projekteve do ta bëjnë personat e jashtëm profesionist, por nga Maqedonia, derisa në fazën e dytë Komiteti për përzgjedhje të parave të Fondit i përbërë nga pesë persona profesionalë, shtetas të huaj. Vendimin, megjithatë kush do të financohet nuk do ta marrin administrata shtetërore, as nëpunësit nga Fondi, Qeveria apo Ministria e Ekonomisë, por plotësisht do të jetë në duart e personave profesionist", nënvizoi Despotovski.

## REAGON SHOQATA E GAZETARËVE TË MAQEDONISË

## Gjykatat po diskreditojnë mediat onlajn

Shkup, 8 maj - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ka shprehur pakënaqësi nga mënyra se si Gjykata Civile në Shkup dhe Gjykata e Apelit në Shkup, zbatojnë Ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje. Pavarësisht dispozitave të qarta të Ligjit, të cilat rregullojnë përgjegjësinë e publikimeve elektronike, këto gjykata vazhdojnë t'i refuzojnë paditë për shpifje dhe fyerje kundër mediave onlajn me sqarim shumë joserioz dhe tendencioz se ato nuk janë media, ndërsa njerëzit që punojnë aty - nuk janë gazetarë. Kjo sjellje e papërgjegjshme dhe jo-profesionale e disa gjykatësve, sipas kreut të SHGM-së, Naser Selmani, do të thotë tentim për të licencuar mediat dhe gazetarët, që paraqet praktikë jodemokratike në

vendet me regjime autoritare.

"Potencojmë se puna e gjykatave nuk është t'i interpretojnë ligjet, por t'i praktikojnë në mënyrë të drejtë dhe joselektive. Dyshojmë se pas kësaj sjellje të Gjyqit Civil në Shkup dhe të Gjyqit të Apelit, ka prapavijë politike, e cila duhet t'i diskreditojë onlajn mediat dhe të sigurojë alibi të rrejshme për qeverinë që të imponojë rregullim më të ashpër ligjor, në kundërshtim me standardet evropiane për lirinë në internet. Paralajmërojmë se përpjekjet e qarqeve të caktuara politike, të cilët kërkojnë regjistrim ligjor të onlajn mediave është lojë e rrezikshme politike, e cila ka për qëllim që shteti ta kontrol-

lojë përmbajtjen e këtyre mediave", ka akuzuar i pari i gazetarëve në Maqedoni, Naser Selmani.

Përveç kësaj, ka shtuar më tej Selmani, qëllimi i gjyqit është t'i parandalojë onlajn mediat dhe gazetarët të cilët punojnë në këto media t'i shfrytëzojnë përfitimet që i ofron ligji për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje, lidhur me dëmshpërblimin jomaterial dhe bazat për përjashtimin nga përgjegjësia për shpifje. "Jemi të bindur se kjo praktikë gjyqësore, e cila për fat të mirë nuk zbatohet në Gjykatat tjera të Apelit në vend, cenon lirinë e të shprehurit dhe e diskrediton profesionin e gazetarisë dhe rolin e medias në një shoqëri demokratike. Kërkojmë nga Gjykata Supreme në Maqedoni të ve-

projë sa më shpejtë për kërkesën e SHGM-së për harmonizimin e praktikës gjyqësore dhe në të ardhmen Gjykata Civile dhe Gjykata e Apelit në Shkup të veprojnë për paditë për shpifje dhe fyerje. Këtë javë do të dërgojmë ankesë deri në Këshillin Gjyqësor për të gjithë gjyqtarët që praktikojnë ligjin në mënyrë selektive me qëllim që të caktohet përgjegjësi për sjelljen e tillë joligjore", është shprehur Selmani, ndërsa i ka bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare, Bashkimit Evropian, SHBA-ve, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës të reagojnë menjëherë te organet gjyqësore dhe të parandalojnë këtë sulm të turpshëm kundër lirisë së të shprehurit, mediave profesionale onlajn dhe përpjekja për licencimin e tyre.



NDRYSHIME LIGJORE PËR LLOGARITË BANKARE

# TRANSPARENCË APO SHKELJE E FSHEHTËSISË SË TË DHËNAVE?

Një pjesë e sektorit të biznesit vlerëson se zgjidhja aktuale ligjore që parashikon DAP, pa një procedurë paraprake të caktuar që të ketë qasje ndaj llogarive të qytetarëve, nevojitet që të përmirësohet në favor të mbrojtjes së fshehtësisë së të dhënave të qytetarëve

Koha **Fisnik PASHOLLI**

Shkup, 8 maj - Afaristët, por edhe ekspertët juridik po e kritikojnë Propozim-ligjin e fundit për banka, i cili i mundëson Drejtorisë së të Ardhura Publike që në çdo moment të ketë qasje të lirë ndaj dokumenteve, transaksioneve dhe depozitave të qytetarëve. Sipas tyre, nevojiten intervenime serioze në ligj me qëllim që të mos rrezikohen të drejtat e qytetarëve në aspektin kushtetues të fshehtësisë së të dhënave dhe të llogarive.

Njëherësh bankat do të japin informacione të tilla edhe për Doganën, nëse ky institucion e parashtron një kërkesë të tillë, e që lidhet me ndonjë pagesë të dhunshme.

Në arsyetimin e propozim ligjit theksohet se këto ndryshime do të mundësojnë që Dogana të realizojë kompensime të dhunshme të obligimeve doganore, ndërsa DAP



më lehtë do të përgatisë raportet vjetore tatimore për vitin pasues, thonë nga Ministria e Financave.

Një pjesë e sektorit të biznesit vlerëson se zgjidhja aktuale ligjore që parashikon DAP, pa një procedurë paraprake të caktuar që të ketë qasje ndaj llogarive të qytetarëve, nevojitet që të përmirësohet në favor të mbrojtjes së fshehtësisë së të dhënave të qytetarëve.

Sipas konsulentit të biznesit, Goran Rafajllovski, të gjitha këto ndryshime ligjore i mundësojnë Drejtorisë së të Ardhura Publike më lehtë të përgatisë paraqitjet vjetore tatimore, mirëpo sipas tij qytetarët do të kenë probleme serioze kur do të fitojnë këto vendime dhe do të parashtronjë ankesa për shkak se kjo procedurë nuk mund të bëhet në mënyrë selektive. Gjithashtu një problem tjetër serioz ka të bëjë me deshifrimin e rrugës së fitimit të parave nga ana e qytetarëve, sqaron Rafajllovski. "Gjithashtu, qasja e tërësish-

me e DAP ndaj llogarive është problem në aspekt të kategorisë kushtetuese të fshehtësisë së të dhënave dhe të llogarive, andaj patjetër nevojitet që të gjendet mënyrë që ajo të përmirësohet, sepse zgjidhja e tanishme nuk është ideale", thekson Rafajllovski.

Nga ana tjetër, në ndryshimet e Ligjit të Bankave thuhet se në bazë të nenit 112 të ligjit, njerëzit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, aksionarët, të punësuarit në banka dhe personat që përmes ofrimit të shërbimeve kanë qasje ndaj dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve që sipas ligjit paraqesin sekret bankar, janë të obliguar ti ruajnë, dhe mund ti përdorin ato vetëm për qëllimet për të cilat janë fituar dhe nuk guxojnë, ti shpalojnë ndaj personave të tretë. Në ligj janë përcaktuar përjashtime nga respektimi i obligimit të lartë përmendur.

Një nga përjashtimet është që DAP mund të ketë qasje ndaj informacioneve dhe të dhënave në bazë

të kërkesës me shkrim që parashtrohet për çdo person individual fizik. DAP prej vitit 2019, do të fillojë të përgatisë paraqitjet tatimore për çdo obligues tatimor. Për shkak të thjeshtësisë së procedurës, DAP ka nevojë të fitojë të dhënat për të ardhurat e realizuara të obliguesve tatimor në të gjitha bazat, pa parashtrimin e kërkesave individuale, dhe në pajtim me Ligjin për ruajtjen e të dhënave personale. Njëherësh, Dogana ka nevojë për të dhënat nga llogaritë transaksionale të qytetarëve, për shkak të realizimit të obligimit ligjor të pagesës së dhunshme të kompensimeve doganore", thuhet në arsyetimin e Ministrisë së Financave për ndryshimin e Ligjit të bankave.

Ndryshe, deri tani, DAP fitonte të dhëna nga bankat vetëm me kërkesë paraprake me shkrim, ndërsa në Ligjin aktual për bankat nuk parashikohet që dogana të ketë qasje ndaj llogarive transaksionale të qytetarëve.



## Qytetarët me diabet nuk do të mbeten pa insulinë

Shkup, 8 maj - Qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët marrin insulinë nuk do të mbesin asnjë ditë pa terapinë e nevojshme, deklaroi dje dr. Vladimir Milloshev, sekretar shtetëror në Ministrinë e Shëndetësisë. "Sipas marrëveshjes ekzistuese për furnizim të insulinës, marrëveshja dyvjeçare gusht 2016-gusht 2018, nga të gjitha llojet e insulinës ka mjaft sasi. Vetëm paraqet problem të vogël "novorapid"-i të cilin e kemi vetëm edhe për një muaj e gjysmë. Tashmë kërkojmë mënyrë të kryejmë import intervenues dhe procedurë shitesë të tenderit për një muaj e gjysmë që të arrijmë deri në gusht kur do ta hapim pakon e kompletuar për furnizim publik të marrëveshjes së re dy vjeçare për furnizim të insulinës", tha Milloshev. Ai sqaroi se procedura e rregullt do të jetë në muajin gusht. "Një muaj e gjysmë është në pyetje që ta plotësojmë atë vakum hapësirë deri në shpalljen e procedurës së tërësishme. Një muaj e gjysmë është periudhë e mjaftueshme që të mbulohej nevojat e qytetarëve. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët marrin insulinë nuk do të mbesin asnjë ditë pa sasitë e nevojshme të insulinës", porosi sekretari shtetëror në Ministrinë e Shëndetësisë. Në pyetjen e gazetarëve se qytetarët në periudhën e fundit janë ankuar për sasitë dhe cilësinë e insulinës, ai sqaroi se tashmë në procedurë parlamentare janë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ilaçe dhe pajisje mjekësore në të cilat janë parashikuar kriteret shtesë për përkeqësim të gjithë asaj që do të thotë cilësi në sigurimin e importit paralel të ilaçeve. Këtu është përfshirë edhe insulina. Shfaqti shpresë se deri në fund të këtij muaji ligji do të përkrahet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa pas shpalljes në "Gazetën zyrtare" do të hyjë në fuqi. "Gjithë ajo që do të thotë import paralel do të garantojë cilësi të ilaçeve të cilat do të jenë lëndë e këtij importi", tha Milloshev.

MINISTRI BEKTESHI TAKOI MINISTRIN NGA INDIA, TAMTA

## Kompani indiane të interesuara për investim në Maqedoni

Shkup, 8 maj - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, dje ishte nikoqir i një delegacioni qeveritar nga India, i kryesuar nga Ministri i Tekstililit dhe Industrisë Ajau Tamta, i cili ndodhet për vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë. Nga Ministria e Ekonomisë informojnë se gjatë takimit ministri Bekteshi tha se Maqedonia dhe India si vende anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë kanë nevojë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Qeverisë së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Indisë paraqet impuls për zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella ekonomike. Është vlerësuar se marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve janë shumë të mira, por se ka nevojë të



intensifikohen, duke theksuar se shkëmbimi tregtar vjetor i cili është 50-60 milionë dollarë mund të shumëfishohet. Ministri Bekteshi e informoi ministrin indian Tamta me kushtet e volitshme që ofron Maqedonia për investitorët potencial nga India, në fusha të ndryshme siç janë industria e tekstilit, që është shumë e zhvilluar,

dhe ka çmime konkurruese si dhe kuadër shumë cilësor. Përveç që mund të hynë në industrinë e tekstilëve, kompanitë indiane mund ta përdorin vendin tonë edhe si qendër e shpërndarjes së produkteve finale nëpër Evropë dhe më gjerë, pastaj në Turqi dhe Ukrainë, vende me të cilat Maqedonia ka marrëveshje për tregti të lirë. Mini-

stri i Tekstililit dhe Industrisë të Indisë Ajau Tamta, falënderoi ministrin Bekteshi për mikëpritjen, duke theksuar se Maqedoninë e ndjen të afërt, para së gjithash sepse është vendlindja e Nënës Terezë. Ai shtoi se kompanitë nga India janë të interesuara për industrinë e tekstilit dhe për investime në sektorin e bujqësisë, por nuk është më i vogël edhe interesi për industrinë e filmit dhe teknologjinë informatike. Në industrinë e tekstilëve në Indi punojnë 45 milion njerëz, ndërsa eksportet vjetore të saj arrijnë 40 miliardë dollarë. Shkëmbimi tregtarë midis Maqedonisë dhe Indisë në vitin 2017 arriti në 54.6 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2016 ishte 64.7 milion dollarë.



Personat, të cilët kanë probleme kronike si astma, diabeti dhe sëmundje të zemrës, duhet të kenë kujdes ndaj alergjive. Parandalimi, diagnoza e hershme dhe trajtimi në kohë janë thelbësore për të shmangur pasojat serioze të shëndetit në njerëz, veçanërisht në organet e frymëmarrjes

PARAQITJA E ALERGJIVE PRANVERORE

# ME MASA KONKRETE KUNDËR POLENIT



## VAKSINA ANTI ALERGJIKE

Doktor Dejan Dokiç, nga Klinika e Pulmologjisë dhe alergjive, në Shkup, është përfshirë në gjetjen e vaksinës anti-alergjike. Përmes vaksinës, njerëzit alergjikë krijojnë një antitrop të vërtetë dhe eliminohet alergjia. "Pas dy, deri tre vjetëve të vaksinimit, pacientët bëhen njerëz të shëndetshëm. Rezultatet e para të vaksinës mund të ndjehen në dy deri në tre muaj", thotë dr. Dokiç.



dhe masa medikamentozë që zakonisht mund të jenë preparate për larjen e syrit, por edhe preparate anti-kongesive, si dhe anti-histaminikët, si preparat që mund të përdorim nëse zgjatim këto simptome mbi shtatë ditë.

### ÇFARË ËSHTË ALERGJIA?

Alergia është ndjeshmëri të disa substancave, të cilat i përthithim, me të cilat bijmë në kontakt me ose i përcjellim përmes ushqimit, përderisa reaksioni alergjik është përgjegjës për sistemin imun të organizmit drejt prurjes së substancave alergjike. Kontakti me të gjitha substancat vjen deri te reaksioni përmes trupave të huaja, alergjenëve dhe trupave të tyre - antitropave. Antitropat, të cilat janë përgjegjëse për shfaqjen e reaksionit të alergjive përfshihen në grupin imunoglobuline E.

Personat, të cilët janë me probleme kronike si astma, diabeti,

dhe sëmundjet e zemrës duhet të kenë kujdes ndaj alergjive. Mjekët thonë se nga alergjitë janë të prekur më shumë pacientët që vuajnë nga astma, të cilët shpesh kanë edhe ndërlikime. Parandalimi, diagnoza e hershme dhe trajtimi në kohë janë thelbësore për të shmangur pasojat serioze të shëndetit në njerëz, veçanërisht në organet e frymëmarrjes. Mjekët për alergjitë paralajmërojnë se niveli i lartë i polenit është në mes orës 10 deri në orën 16 sidomos kur ditët janë me erë, të nxehta dhe të thata, sepse njerëzit të ndjeshëm ndaj

reaksioneve alergjike janë të këshilluar që të dalin për shëtitje, por pasdite vonë dhe në ditët në vijim menjëherë pas reshjeve të mëdha.

### NJË NË KATËR PERSONA VUAJNË NGA ALERGJIA NË MAQEDONI

Sipas të dhënave statistikore, 1/3 e popullatës në botë vuan nga alergjia. Ndërsa çdo i katërti qytetar i Maqedonisë vuan nga ndonjë lloj alergjie, pa marrë parasysh nëse është alergji ndaj polenit, alergji ndaj barnave, ushqimit, etj. Alergjia gjithashtu është problem te foshnjat dhe të moshuarit.

## Pagesa e subvencioneve për duhanin nis javën e ardhshme

Shkup, 8 maj - Pagesa e subvencioneve për duhanin nga rekolta 2017 do të fillojë javën e ardhshme, ndërsa subvencione të rritura do të marrin mbi 23.400 kultivues të duhanit, kumtoi sot Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU). Sipas MBPEU-së, nga sot deri në fund të kësaj jave Agjencia Pagesore do t'i implementojë kontrollet ligjore në kompanitë blerëse pas çka pason përpunim i zgjidhjes për pagesën e subvencioneve për duhanin. Me mënyrën e re të subvencionimit në tre nivele që fillon me rekoltën 2017, subvencionimi për klasën e parë të duhanit është 80 denarë, për të dytën 70, ndërsa për të tretën, të katërtën dhe klasën shtesë është 60 denarë. "Qëllimi i modelit të ri të subvencionimit është që të shtyhen kultivuesit e duhanit që të prodhojnë duhan më cilësor që të fitojnë subvencionim më të lartë. Prodhimtaria e duhanit është degë e rëndësishme për bujqësinë e Maqedonisë, e cila sjell të hyra të devizave nga rreth 100 milionë euro në vit", thonë nga Ministria. Njëherit informojnë se sot në Gazetën Zyrtare u publikuan ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural nga të cilat një pjesë parashikojnë anulim të rëndësishëm të kushteve për detyrime të përfunduara drejtë Drejtorisë së të Ardhurave Publike të cilat vitet e kaluara ishin pengesë për pagesën e subvencioneve. "Me këtë ndryshim krijohen kushte ligjore për pagesë me kohë të subvencioneve, në mesin e të cilave është edhe pagesa e subvencioneve për duhanin nga rekolta 2017", thekson Ministria.

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 8 maj - Bashkë me rrezet e diellit dhe aromën e luleve, pranvera sjell edhe alergjitë e ndryshme dhe njerëzit më shumë ankohen prej efekteve jo të mira shëndetësore që shkakton poleni i luleve e pemëve.

Raportet e mjekëve janë të mbushur me raste të shumta të pacientëve që ankohen nga alergjitë e polenit. Një sqarim më profesional për shkaktarët dhe efektet e polenit, morëm nga mjekja dr.Vesela Hristovska nga klinika "Prima-Med", e cila sqaron se për çdo vit, numri i të prekurve nga alergjia e polenit rritet dhe në raste të rralla mund të shndërrohet në reagim astmatik. Për atë arsye ajo rekomandon që të mos injorohet nevoja e konsultimit me ekspertët të kësaj fushe, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijët me alergji ndaj polenit.

Mjekët japin sqarime të ndryshme sa i përket simptomave që paraqiten prej alergjive të polenit. Sipas pulmologes Sofjane Bellqishta, ndër simptomat e shpeshta janë: lotimi i syve, kruarja e syve, teshtitja, kollitja, skuqja e fytyrës dhe duarve që mund të jenë në formë e puçrrave. Ajo nuk përjashton faktin se edhe imuniteti i dobët i njeriut edhe trashëgimia gjenetike, bëjnë që të preken nga alergjia dhe këta persona duhet t'i shmangen daljes në natyrë. Për këtë arsye, ajo rekomandon që të përdoren disa masa mekanike, siç janë larja e syve me ujë të pastër

## ASH kërkon revizion në punën e Arifit



Tetovë, 8 maj - Aleanca për Shqiptarët - Dega e Tetovës përmes një pres konference ka akuzuar kryetaren e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, se nuk ka përmbushur premtimet e dhëna para qytetarëve. Sipas Aleancës për Shqiptarët, edhe përkundër premtimeve ende nuk kanë filluar punët për ndërtimin e shkollës fillore në Reçicë të Vogël dhe Sellcë, si dhe ka iniciuar kërkesë për keqpërdorim të mjeteve financiare deri tek enti shtetëror për revizion.

"Ne i jemi drejtuar me një kërkesë Agjencisë Shtetërore për Revizion që të bëjë kontrollin fi-

nanciar në Komunën e Tetovës për vitet 2015, 2016, 2017 në menaxhimin e mjeteve financiare, ku ne dyshojmë se kemi keqpërdorim dhe keqmenaxhim të mjeteve buxhetore të taksapaguesve tetovarë. Shpresojmë se institucioni shtetëror i Revizionit të Maqedonisë do të punojë në mënyrë të pavarur dhe ti bëjë publike furnizimet publike, investimet publike dhe borxhin publik, për të vetmen arsye - qytetarët ta kenë të qartë se ku shkojnë taksat e tyre", deklaroi Altrim Mamuti, kryetar i Degës së Aleancës për Shqiptarët në Tetovë. Në ndërkohë, nga Zyra për informim

në Komunën e Tetovës kanë thënë se të gjitha partitë opozitare u bënë bashkë kundër Teuta Arifit dhe humbën në zgjedhje, kurse raportet e fundit të Entit shtetëror për revizion kanë treguar se nuk ka patur keqpërdorime.

"Këto akuza ne nuk i marrim shumë seriozisht, sepse të gjitha partitë opozitare u bënë bashkë dhe pësuan debakëll gjatë zgjedhjeve dhe aq më pas vijën nga një parti që ka vetëm dy deputetë. Ne u sugjerojmë atyre që të lexojnë më mirë Raportet e Revizionit dhe më pas të flasin", tha zëdhënësi Fazliu. (U.H)

**K**a kohë që tema më e nxehtë me të cilën hapen edicionet e lajmeve të mediave kryesore, por edhe të atyre më pak të rëndësishme, është rikonstruimi i qeverisë. Dhe, gati se gjithmonë, brenda lajmeve që ndërliken me temën në fjalë përshkohen dy çështje si arsye për një hap të tillë të kryeministrit: zgjerimi i shumicës parlamentare dhe përmirësimi i kualitetit të kuadrove që udhëheqin me dikasteret qeveritare. Përderisa vet kryeministri, gati se gjatë gjithë paraqitjeve të tij publike, gjatë arsyetimit të nevojës për riformatim të kabinetit qeveritar preferon të vë theksin te përzgjedhja bazuar në dimensionin kualitativ të kuadrove me të cilët bashkëqeveris, veprimet e tij gjithnjë e më shumë tregojnë një tendencë tjetër, atë të nevojës për zgjerim të shumicës parlamentare me qëllim të forcimit të pozicionit të tij.

Nuk duhet harruar se kjo qeveri u mandatua në kushte të jashtëzakonshme, ashtu siç ishin edhe kushtet e sigurimit të shumicës parlamentare. Aq dramatike ishin momentet e sigurimit të kësaj shumice, sa që të shumtë ishin zërat që drejtonin gishtin edhe drejtë partnerëve strategjikë të Maqedonisë në arenën ndërkombëtare, si shkaktarë për ndryshim të qëndrimit të BDI-së në orët e fundit kur disa nuk hezituan që të përhëndesnin formimin e qeverisë VMRO-BDI. Një zë i tillë vinte edhe nga kupola e shtetit, presidenti.

Atëbotë, gjatë krijimit të qeverisë, gati se të gjitha forcat me orientim reformator të saj në drejtim të rikthimit të agjendës së integritetit të vendit në strukturat euro-atlantike e pranuan kyçjen në qeveri të njërit ndër shkaktarët e krizës në shtet, që ishte BDI, e cila bashkëqeverisi me VMRO-në për gati dhjetë vjet. Për hir të së vërtetës, nuk ishin të paktë zërat mosbesues në rezultatet e një qeverie, e cila si faktor kyç do të kishte BDI-në, duke mos harruar se ajo do ta kishte gati se të pamundur të reformohej duke qenë pjesë e qeverisë. Kishte edhe mendime të tilla që deklaroronin se me BDI-në në qeveri, lëre se ajo (pra, BDI) nuk do të reformohej, por edhe vetë qeveria do ta kishte të pamundur realizimin me sukses të objektivave të saj reformatore.

Dhe, kjo tendencë e orientimit drejt zgjerimit të shumicës, në dëm të kualitetit të kuadrove qeveritare, fillet e saj i ka që në momentet e para kur kryeministrit iu ofrua mundësia që të bëjë një zgjedhje të tillë. Mundësia e parë që iu dha kryeministrit për ta larguar nga qeveria një ndër partnerët që ia siguruan shumicën në ato kushte dramatike të formimit të saj, ai fare nuk hezitoi që ta shfrytëzoj. Kjo edhe nuk do të ishte aq dramatike nëse ndryshimi i aktorëve nuk do të nënkuptonte edhe diçka shumë substanciale. Largim të atyre që sakrifikan për të siguruar shumicën dhe futje në lojë e të tjerëve që ishin në

## Rikonstruimi i Qeverisë, çka dhe si?

mesin e atyre që shtetin e sollën buzë greminës.

Por, loja nuk mbaroi. Ajo vazhdoi, tanimë me aktorë të ri, por esenca mbeti e njëjtë. Edhe më tej, njëri ndër përcaktimet prioritare të kryeministrit mbeti zgjerimi i shumicës. Por, tanimë aktorët e ri futeshin në lojë në emër të relaksimit të pozicionit të aktorëve të tanishëm, por në fakt qëllimi ishte krejt tjetër, relativizimi i rolit të tyre. Dhe përsëri e përsëri po i njëjti tregim. Që kontradikta të jetë edhe më e madhe, ky relativizim i rolit të aktorëve me të cilët bashkëqeveris kryeministri nuk është në drejtim të rritjes së përkushtimit të tyre reformues drejt integriteteve euro-atlantike, por ka të bëjë me disiplinimin e tyre që të dinë se kush është kryesori dhe kush merr vendime në qeveri.

Derisa kryeministri kishte mundësi që të zgjeroj shumicën parlamentare duke futur në lojë aktorë që njëherësh edhe do t'i mundësonin që të përmirësoj dukshëm kualitetin e kuadrove me të cilët bashkëqeveris, ai zgjodhi që përparësi t'u jap atyre që nuk do t'i bënin problem në vendimmarrje, por të vetmin kusht e kanë që të futen nën ombrellën e qeverisë. Dhe përsëri dallimi i aktorëve është esencial. Derisa të parët, kanë përkrahur qeverinë gati se në të gjitha vendimet e saj reformatore pro integriteteve euro-atlantike, pa hezituar në asnjë moment dhe pa e kushtëzuar

qeverinë me pozicione ministrore, të dytët gati se në vazhdimësi ndërsa kanë biseduar për t'u kyçur në qeveri, kanë koketuar dhe vazhdojnë që të koketojnë me VMRO-në për të diskutuar mundësinë e një bashkëqeverisje me të. Nuk duhet harruar faktin se njëri ndër aktorët më të përfolur për të qenë pjesë e kësaj qeverie është po ai i cili para dhjetë viteve, duke bashkëqeverisur me VMRO-në, gati se e solli vendin para një lufte qytetare, duke tentuar që të deformatojë rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2008.

Përderisa, arsyetimi i kryeministrit dhe përkrahësve të tij për përfshirjen e BDI-së në qeveri, në momentin e formimit të saj, ishte thjeshtë çështja e numrave, shtrohet pyetja se cili është arsyetimi i tyre tani kur kryeministri po bisedon për të bashkëqeverisur edhe me disa aktorë të tjerë, po ashtu bashkëpunëtorë të afërt të VMRO-së. Bile, nuk do të ishte ironike teza se si do të veprojnë kryeministri nëse nesër Gruevski me disa nga bashkëpunëtorët e tij më besnikë shpëputet nga partia amë dhe i ofrohet atij si bashkëpunëtor i mundshëm në qeveri. Them se fare nuk është ironike, sepse veprimet e deritanishme të kryeministrit japin sinjale të tilla. Fillimisht, me pranimin si anëtar i organeve më të larta të strukturës së tij partiake të një aktori që deri dje ishte në kampin e kundërt vetëm se ai është një votë në parlament, duke vazhduar

**Është koha e fundit që të ndryshojë qasja kundruall qeverisjes e jo vetëm qeveria. Mjaft më me tregime të bukura, sepse shpejt mund të vijë koha që nuk do të kemi se kujt t'ia tregojmë ato. Rinia po na ikë çdo ditë e më shumë dhe kjo është indikator më i mirë se diçka nuk është në rregull me qeverinë dhe ofertën e saj për një jetë më të mirë**



me aktorin tjetër të qeverisë së VMRO-së i cili ishte simboli i nënçmimit të kundërshtarëve politikë në disa cikle zgjedhore duke i shërbyer me pasion Gruevskit dhe klikës së tij. Dhe, e fundit, mundësia që i ofrohet kryeministrit që të fus nën sqetull edhe njërin ndër aktorët për të cilët prokuroria speciale ka lëndë aktive për ngjarjet e prillit.

Cili do të ishte kursi i një qeverie e cila brenda do t'i kishte të gjithë bashkëpunëtorët më të afërt të Gruevskit. A thua vallë po na përsëritet historia, por tanimë me aktorë të ri dhe me tregime të reja. Edhe me herët jemi ballafaquar me situata të tilla, kur partitë politike për të ardhur në pushtet kanë kritikuar qeverinë për gjitha vendimet dhe veprimet e saj duke ofruar ndryshim të kursit qeverisës, por e vetmja gjë që ka ndryshuar ka qenë kryeministri dhe bashkëqeveritarët e tij, kurse qeverisja ka ngelur po ajo e njëjta.

Është koha e fundit që të ndryshojë qasja kundruall qeverisjes e jo vetëm qeveria. Mjaft më me tregime të bukura, sepse shpejt mund të vijë koha që nuk do të kemi se kujt t'ia tregojmë ato. Rinia po na ikë çdo ditë e më shumë dhe kjo është indikator më i mirë se diçka nuk është në rregull me qeverinë dhe ofertën e saj për një jetë më të mirë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga Bilal KASAMI

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e martë 8 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Problemi i Kosovës është veçantia

Analizë e gazetës  
spanjolle El PAIS

Jo të gjitha problemet kanë një zgjidhje dhe jo të gjithë ofrojnë një zgjidhje që të kënaqë pjesët e interesuara. Kosova është një shembull i qartë. Kur një pjesë e komunitetit ndërkombëtar me SHBA në krye vendosi të nxisë pavarësinë e kësaj ish province serbe, u fut në një kopsht ligjor nga i cili është vështirë të dalësh pa kapërcyer parime të drejtave dhe pa thyer premtime që u bënë në kohët e luftës. Kosova nuk ka ngjashmëri me Katalunjën, as edhe Spanja me ish- Jugosllavinë; as për historinë e saj, as edhe për sistemin e saj politik, qoftë edhe për problemet që pati ky vend ballkanik.

Problemi që krijon pavarësia e njëanshme e Kosovës është veçantia e saj (përjashtimi), është ideja që, nëse konsiderohet e nevojshme, komuniteti ndërkombëtar mund të thyejë normat e veta. E gjitha kjo nuk do të thotë se pavarësia e Kosovës nuk është e justifikuar, që shqiptarët e atij territori nuk e kanë fituar të drejtën për të ndërtuar një vend, por nuk mund të fshihet fakti që e fitoi pavarësinë në kundërshtim me shtetin të cilit i përkiste, Serbisë, dhe në kundërshtim të hapur me premtimin që komuniteti ndërkombëtar bëri në Beograd kur trupat e Natos hynë në vitin 1999. Për këto motive, qeveria spanjolle, pak rëndësi ka kahu politik, është treguar gjithmonë kundër njohjes së Kosovës dhe që ka hapur shumë debate diplomatike. Kosova e shpalli pavarësinë në shkurt të 2008 dhe në mars të 2009 qeveria socialiste e Jose Luis Rodrigues Zapatero njoftoi tërheqjen e trupave spanjolle që bënin pjesë në Kfor, misioni ndërkombëtar, i cili mbikëqyrte sigurinë e territorit. Siç tregojnë kabllogramat diplomatike të nxjerra nga Wikileaks dhe të publikuara në 2010, tërheqja irritoi shumë nga kolegët, sidomos ata amerikanë.

Një kabllogram sekret i diplomacisë amerikane sinjalizonte që Uashingtoni kritikoi mungesën e konsultave para tërheqjes dhe i kërkoi Spanjës që të konsultohet me Amerikën më parë, në një formë më transparente. Dokumenti nënvizon se shpjegimi që kishte dhënë qeveria spanjolle ishte: "Ka marrë vendimin për t'u tërhequr prej një viti dhe nuk mund të marrë pjesë në një mision, kur Kosova ka shpallur pavarësinë dhe është njohur nga shumë vende." Autori i këtij kabllogrami shpjegon: "Çdo lloj indicie që qeveria spanjolle mbështet shpërbërjen e një vendi,



në përbërës rajonalë, do të ishte shumë e ndjeshme politikisht dhe do të nxiste separatizmin".

Një dekadë më vonë, përpara sfidave të pavarësisë katalanase, referendumi joligjor i 1 tetorit dhe aplikimi i nenit 155 ka bërë që situata të përkeqësohet. Kështu që qeveria konservatore e Mariano Rajoyit ka vënë veton ndaj një deklarate të përbashkët të Bashkimit Europian, që do të prezantohet në samitin ballkanik në 17 maj. Arsyeja është se deklarata përfshin Kosovën. Ka edhe 4 shtete që nuk e kanë njohur këtë vend: Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia. Në një intervistë, kryeministri i Kosovës, ish luftëtar, Ramush Haradinaj këmbëngulte se nuk ka asnjë analogji të mundshme: "Kosova dhe Katalunja nuk kanë asgjë të përbashkët. Kosova ka lindur nga shpërbërja e Federatës Jugosllave, një proces i përgjakshëm, të gjithë kundër të gjithëve. Në rastin e Spanjës respektohen të drejtat civile dhe politike". Problemi nuk janë analogji të. Jugosllavia u shpërbë në vitet 90. Vendi i krijuar si një monarki pas Luftës së Parë Botërore dhe rithemeluar si një federatë socialiste pas asaj të Dytë, ishte i përbërë nga 6 republika (Serbia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja-Hercegovina) dhe nga dy provincat autonome serbe, Kosova dhe Vojvodina. Situata e Kosovës ishte tejet shpërthyes dhe shumë ekspertë besojnë që luftërat e Jugosllavisë filluan aty, kur Beogradi tërhoqi autonominë e saj në 1990 dhe për-

Qeveria konservatore e Mariano Rajoyit ka vënë veton ndaj një deklarate të përbashkët të Bashkimit Europian, që do të prezantohet në samitin ballkanik në 17 maj. Arsyeja është se deklarata përfshin Kosovën. Ka edhe 4 shtete që nuk e kanë njohur këtë vend: Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia. Në një intervistë, kryeministri i Kosovës, ish luftëtar, Ramush Haradinaj këmbëngulte se nuk ka asnjë analogji të mundshme: "Kosova dhe Katalunja nuk kanë asgjë të përbashkët. Kosova ka lindur nga shpërbërja e Federatës Jugosllave, një proces i përgjakshëm, të gjithë kundër të gjithëve. Në rastin e Spanjës respektohen të drejtat civile dhe politike"

funduan aty kur presidenti serb, Slobodan Millosheviç nisi një fushatë spastrimi etnik kundër shqiptarëve.

Kosova konsiderohet si atdheu i nacionalizmit serb, sepse aty gjenden manastiret ortodokse mesjetare kryesore dhe sepse aty ndodhi në 1389 beteja e fushës së Kosovës, ku Serbia humbi pavarësinë përballë turqve. Kosova ka një popullsi prej 10% serbë dhe 90% shqiptarë që jetonin agoninë në një aparted gjithnjë e më të paqëndrueshëm. Në vitin 1998 ishte luftë e hapur dhe në 1999 ndërhyri Nato me një fushatë bombardimesh kundër Serbisë, nga 24 marsi deri në 10 qershor. Pas një periudhe si protektorat ndërkombëtar, një masakër anti-serbe që ndezi provincën në mars të 2004 e detyroi komunitetin ndërkombëtar të vendoste se gjërat s'mund të vazhdonin kështu dhe pas negociatave që nuk çuan në një pakt me Beogradin, Kosova shpalli pavarësinë. Në vitin 2010 Prishtina arriti një fitore kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë së Kombeve të Bashkuara dekretoi se pavarësia kishte qenë e ligjshme. Kjo gjykatë iu përgjigj pyetjes së shtruar nga Beogradi: "Shpallja e njëanshme e pavarësisë së institucioneve të perkohëshme të administratës autonome të Kosovës, është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?" Përgjigjja e Gjykatës prej 45 faqesh përmblidhet thjesht me një: "Jo, jo nuk e çënon" Hisashi Owada, presidenti i Gjykatës së Kombeve të Bashkuara

ra e formuloi kështu: "E drejta ndërkombëtare e përgjithshme nuk parashikon ndalime mbi shpallje pavarësie dhe për këtë arsye deklarata e 17 shkurtit të 2008 nuk çënon të drejtën ndërkombëtare".

Problemi me të cilin u ndesh Gjykata nuk ishte vetëm fakti se shpallja e Kosovës ishte e njëanshme, por edhe rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë që lejoi hyrjen e trupave ndërkombëtare dhe që ripohonte, "respektimin e shteteve anëtare, parimin e sovranitetit dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të shteteve të rajonit". Gjykata i dha fund kësaj çështje me 9 vota pro dhe 5 kundër, këmbëngulte se roli i saj ishte të mos gjykonte, nëse ekzistonte një e drejtë ndarjeje, duke dhënë një zgjidhje për një konflikt të pazgjidhshëm dhe përsëriste disa herë që bëhej fjalë për një situatë të veçantë, një rast unik, të paaplikueshëm për kombe të tjera.

Kosova arriti pavarësinë, sepse shtetasit e saj vuajtën një sulm të ashpër e mbi të gjitha patën mbështetjen e shumë vendeve të fuqishme si Amerika. Duke qenë se Europa ka qysh prej 2008 një shtet të ri të themeluar kundër kriterit të shtetit që i përkiste, pas një shpallje të njëanshme të pavarësisë dhe duke thyer një premtim të realizuar para Këshillit të Sigurimit, është e pamundur që një qeveri spanjolle të ndihet komode me këtë zgjidhje për një problem të pazgjidhshëm, të paktën deri kur të pranohet nga vetë Serbia.



## Pa njohje nga Serbia, s'ka avancim në marrëdhënie

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë thirrje për zgjerim të shpejtë të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor. "Zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor ka të bëjë me parandalimin e ndikimit të ideologjive të rrezikshme dhe me ndikimin e fuqive tjera anti-evropiane dhe anti-perëndimore", ka thënë Thaçi në një intervistë për gazetën gjermane "Handelsblatt" (edicioni i së mërkurës). "Në këto rrethana, ne shpresojmë të përshpejtojmë rrugën e Kosovës drejt Evropës". "Më duhet të paralajmëroj kundër një hezitimi apo edhe tërheqjeje të BE-së nga rajoni: BE-ja nuk ka llogari të hezitimit në Ballkan, në të kundërtën do të rritet ndikimi i Rusisë", ka paralajmëruar Thaçi, transmeton Koha.net. "BE-së nuk i konvencion një vrimë e zezë në Ballkan", thotë Thaçi, vendi i të cilit, siç shkruan kjo gazetë, është në vendin e fundit për sa i përket listës së kandidatëve për anëtarësim në BE nga Evropa Juglindore. Pajtimi është kusht kyç për anëtarësim në të ardhmen në BE. Thaçi, vetëm pak ditë më parë, nënshkroi marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi. Vendi fqinj, për dallim nga Serbia, njeh pavarësinë e Kosovës. "Jam shumë i interesuar në ndërtimin e marrëdhënieve normale me Serbinë, në çka edhe varet e ardhmja e vendit tonë, dhe nuk guxojmë të ankohe mi për kohët e kaluara, por të punojmë për të ardhmen", tha presidenti Thaçi për gazetën gjermane, transmeton Koha.net. "Nuk është në interesin e Serbisë, por në interesin e të gjithë rajonit që të avancojmë kah marrëdhëniet tona bilaterale, por një kusht është i pashmangshëm që Serbia të njohë fqinjin e saj Kosovën si shtet të pavarur", përfundoi Thaçi.

# SA KA PUNË PËR 70 ZËVENDËSMINISTRA?

Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, këto pozita qeveritare i kushtojnë buxhetit deri në tre milionë euro në vit, pasi paga mujore e një zëvendësministri është rreth 1200 euro. Zëvendësministri ka të drejtë të ketë edhe staf përcjellës, si asistentë dhe shoferë personal

Në kabinetin qeveritar të udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj, janë të punësuar mbi 70 zëvendësministra, numër ky që vazhdimisht është kritikuar nga përfaqësues të shoqërisë civile me konstatimin se përveç që dëmton buxhetin e Kosovës e bën jo funksionale edhe punën e qeverisë. Në opinion, shpesh është ngritur edhe dilema se çka mund të punojnë të gjithë këta zëvendësministra, marrë parasysh që edhe vendet me popullatë shumë më të madhe sesa Kosova nuk kanë numër kaq të madh të të punësuarve në postet nënministrorë.

Se ka numër të madh të zëvendësministrave në qeveri, këtë e pranojnë edhe vet ata. Koalicioni aktual qeverisës përbehet nga Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Social Demokrate,



Aleanca Kosova e Re, Lista Serbe e cila merr pjesë vetëm pjesërisht në punën e ekzekutivit dhe disa parti tjera më të vogla. Ali Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është zëvendësministër i Shëndetësisë. Berisha thotë se detyrat në ministrinë ku ai punon janë të ndara, por që nuk e mohan faktin se numri i madh në raste të caktuara, pengon punën efikase.

"Meqenëse ishte marrëveshje e caktuar politike, pasi qeveria aktuale është e krijuar nga shumë parti politike, bazuar në atë marrëveshje është një numër i tillë i ministrave. Por, sikur të ishin më pak ministra do të ishin më funksional", tha Berisha. Vesel Krasniqi nga partia Nisma për Kosovën është zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Krasniqi, që radhitet në mesin e pesë zëvendësministrave të tjerë në këtë ministri, thotë se angazhimi dhe punë ka për të gjithë, por në raste të caktuara, shprehet ai, ky numër mund të komplikojë punët. "Është pak e vështirë, jo për ne

si zëvendësministra, mirëpo pak është e vështirë për departamentet, për drejtoritë të cilët duhet të raportojnë dhe secili kërkon shënime, raporte prej tyre", thotë Krasniqi. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përveç ministrit, ka të punësuar edhe pesë zëvendësministra. Vesel Makolli është njëri prej tyre. Ai mendon se në këtë ministri ka shumë punë dhe është e nevojshme të ketë një numër kaq të madh të zëvendësministrave. Por, nga shoqëria civile kritikohet ashpër punësimi i një numri kaq të madh të zëvendësministrave. "Një numër kaq i madh i zëvendësministrave dhe pozitave politike, nuk është caktuar për të kryer punë të domosdoshme në Qeveri, por për të përmbushur egot e partive politike për pozita të larta qeveritare", ka thënë Arton Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet "Çohu". "Përpos ngarkesës buxhetore që i bëhet, është një lloj papërgjegjësie, mosdije se kush është përgjegjës për ngecje në një

fushë të caktuar. Nuk dihet se a është përgjegjës ministri apo cilido zëvendësministër. Përgjegjësia është shpërndarë dhe nuk dihet se kush është përgjegjësi kryesor", thotë Demhasaj. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga 21 ministrat e qeverisë se tij, që t'u delegojnë punë dhe përgjegjësi secilit zëvendësministër, në mënyrë që ky numër aq i madh të kthehet në dobi për qytetarët e vendit. Ndryshe, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, këto pozita qeveritare i kushtojnë buxhetit deri në tre milionë euro në vit, pasi paga mujore e një zëvendësministri është rreth 1200 euro. Zëvendësministri ka të drejtë të ketë edhe staf përcjellës, si asistentë dhe shoferë personal. Në anën tjetër, shefja e zyrës se shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, javën e kaluar ka thënë se do të dëshironte që paratë që shpenzohen për pagat e 75 zëvendësministrave të përdoren për reformë të thellë në arsim.

## Shkak Kosova, Samiti i Sofjes mund të dështojë!

Bashkimi Evropian po përpiqet me finesë diplomatike të pengojë përplasjet për shkak të Kosovës në samitin e Ballkanit Perëndimor javën e ardhshme në Sofje. Vendet që nuk e kanë njohur Kosovën kërcënojnë me bojkot

Grindja e vazhdueshme në disa vende të BE-së për statusin e Kosovës hedh hije në përgatitjet e samitit të Ballkanit të BE-së në Sofje më 17 maj. Një javë para samitit të BE-së shenjat duken ende se janë për konfrontim. Pesë vende të BE-së nuk e pranojnë njohjen e Kosovës. Greqia, Rumania, Sllovakia, Spanja dhe Qipro duan ta bëjnë



këtë të qartë edhe në samitin e BE-së në Sofje. Sipas tyre asnjë simbol në këtë samit nuk duhet të interpretohet sikur pavarësia e Kosovës e shteti i Kosovës janë të pakontestuar. Për të mundësuar zhvillimin e samitit siç është planifikuar, BE përpiqet tani me finesa diplomatike. Kështu në deklaratën përfundimtare të takimit në Sofje nuk do të flitet për vendet e Ballkanit

Perëndimor, por për partnerët e Ballkanit Perëndimor, njofton agjencia e lajmeve DPA, duke iu referuar qarqeve të BE. Nga ana tjetër edhe vendet, ku do të ulen krerët e shteteve dhe qeverive të BE-së, do të shenjojnë me emrat e tyre dhe jo si zakonisht me emrat e vendeve. Me këto rregullime, organizatorët shpresojnë që të mos bojkotohet samiti i Ballkanit Perëndimor.

Vetëm kreu i qeverisë spanjolle, Mariano Rajoy, megjithë lëshimet e bëra nuk do të marrë pjesë në samit, bëhet e ditur nga diplomatët e Brukselit. Në Madrid u tha së fundmi, se para sfondit të lëvizjeve separatiste në Katalonjë, Rajoy nuk do që të dalë në fotografi me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Në Samitin e Sofjes do të flitet për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Por nuk mendohet se BE do të ofrojë një kohë të saktë anëtarësimi. Kur Komisioni Evropian në strategjinë e Ballkanit të prezantuar në shkurt ofroi si datë të mundshme anëtarësimi vitin 2025 për Serbinë dhe Malin e Zi, pati reagime kundërshtuese nga vendet anëtare. Kritikët thonë se Ballkani është ende shumë larg përmbushjes së kriterëve që duhen për anëtarësim në BE.

## 40 për qind e fëmijëve vuajnë nga varfëria

Në një deklaratë nga Observatori Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor në Marok thuhet se 40 për qind e fëmijëve të cilët jetojnë në këtë vend po vuajnë nga "varfëria shumëdimensionale". Në një konferencë për media të mbajtur në kryeqytetin Rabat nga Observatori Kombëtar i Zhvillimit

Njerëzor u prezantuan rezultatet e një studimi të përbashkët me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF). Në studimin e realizuar për fëmijët janë përfshirë fëmijët deri në moshën 17 vjeçare, duke u bazuar në kriteret e shëndetësisë, ushqimit, arsimit, qasjes në ujë, vendbani-

mit, sigurisë shëndetësore dhe komunikimit. Fëmijët të cilët nuk kanë qasje në të paktën 2 prej kriterëve të cilat janë baza e studimit, vlerësohet se janë "në varfëri shumëdimensionale". Sipas hulumtimit, 39.7 për qind e fëmijëve marokenë vuajnë nga varfëria shumëdimensionale dhe

se 68.7 për qind të këtyre përbëhen nga fëmijët të cilët jetojnë nëpër fshatra. Gjithashtu thuhet se gjatë 30 viteve të fundit në Marok është arritur në zhvillime të rëndësishme sidomos në fushat si shëndeti e fëmijës dhe nënës, arsimimi, zhvillimi dhe mbrojtja e fëmijëve.



## Erdogani i përgjigjet Francës: Jeni të ulët

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka shprehur kritika të ashpra ndaj kërkesës skandaloze të shkrimtarëve francezë dhe politikanëve të caktuar, përfshirë edhe ish-presidentin Nicolas Sarkozy, për të hequr fragmente të caktuara nga Kurani. "Kush jeni ju që sulmoni vlerat tona të shenjtë? Ne e dimë se sa të ulët jeni ju. Sepse ju këtë e keni bërë këtë dhe e bëni në çdo vend. Ne nuk ju njohim vetëm sot. Por, pavarësisht këtyre gjërave që ju bëni, ne nuk do të sulmojmë me të njëjtën gjuhë shenjtërinë tuaj, sepse ne nuk jemi të ulët si ju", tha Erdogan në një mbledhje të grupit parlamentar të partisë së tij AK. Ndryshe, më 22 prill, në gazetën Le Parisien u publikua një manifest për "heqjen e disa ajeteve me arsyetimin se përhapin ide të dhunës dhe antisemitizmit", e cila u nënshkrua nga 300 shkrimtarë dhe politikanë, përfshirë edhe ish-presidentin Sarkozy.

## Grekët qëndrojnë më shumë përpara ekranit

Sipas Zyrës Evropiane për Statistika (Eurostat) qytetarët e Bashkimit Evropian (BE) kalojnë mesatarisht 2.5-3 orë në ditë përpara ekranit, kurse turqit mesatarisht 2 orë e 17 minuta. Eurostat publikoi rezultatet e studimit në lidhje me kohën e kaluar përpara ekranit në aktivitetet si shikimi i programeve televizive apo luajtja e lojërave të qytetarët e 15 shteteve të BE-së gjatë viteve 2008-2015. Studimi i realizua me grupmoshën 20-74 vjeç. Të dhënat e Eurostatit tregojnë se qytetarët e BE-së, përveç kohës së punës, mesatarisht 2.5-3 orë në ditë i kalojnë përpara ekranit. Grekët listohen në vendin e parë duke qëndruar më shumë se 3 orë në ditë përpara ekranit, kurse pas tyre vijjnë qytetarët e Belgjikës, finlandezët, britanikët dhe hungarezët. Kurse italianët me 1 orë e 56 minuta janë populli i cili kalon më së paku kohë përpara ekranit në mesin e shteteve të BE-së. Të dhënat po ashtu njoftojnë se turqit me 2 orë e 17 minuta humbin më pak kohë përpara ekranit se në përgjithësi të qytetarëve të BE-së.

# NJË TJETËR ZONJË E PARË DO TË ISHTE MË E DOBISHME



Kritikë nga e gjithë bota kanë komentuar mbi gjuhën e trupit të Zonjës së Parë të Amerikës, Melani Trump. Larry Jakobs, drejtor i Qendrës për Studimin e Politikave dhe Qeverisjes në Universitetin e Minesotës, tha: "Ajo është e pazakontë dhe veprimet e çuditshme të saj na shtojnë të imagjinojmë gjëra që nuk i përkasin as realitetit, e aq më pak Shtëpisë së Bardhë. Pamjet ku shfaqet Melania që i shtyn dorën presidentit Trump, i janë shtuar listës së veprimeve tepër të çuditshme, mos themi të papranueshme, të burrit më të fuqishëm në botë aktualisht.

Zonjat e Para të së kaluarës i

Përgjatë këtyre trekatër dekadave të fundit, Zonja e Parë ka qenë një mjet i mirë politik i presidentit përkatës, për t'u bërë më popullor dhe më i dashur për vendin. Një tjetër Zonjë e Parë ndoshta do të kishte qenë shumë më e dobishme për presidentin Trump

kanë rrëzuar madje dhe barrierat që ndanin forcat politike, duke fituar zemrat e opozitarëve. Barbara Bush, për shembull, iu bëri thirrje për kompromis kundërshtarëve politik demokrat, me anë të programit të saj shkrim/lexim. Nga ana tjetër, Michelle Obama, burri i së cilës jo rralë i provokonte hidhur kundërshtarët e tij, arriti të bënte për vete shumë republikanë me iniciativat e saj. Përgjatë këtyre trekatër dekadave të fundit, Zonja e Parë ka qenë një mjet i mirë politik i presidentit përkatës, për t'u bërë më popullor dhe më i dashur për vendin. Një tjetër Zonjë e Parë ndoshta do të kishte qenë shumë

më e dobishme për presidentin Trump. Ai nuk ka as grimcën më të vogël të afrimitetit me popullin dhe ka tjetërsuar çdo gjë që ka lidhje me pavarësinë dhe gruan. Ajo mund të kishte qenë një ambasadore e vullnetit të mirë si Michelle ose Barbara, por ajo nuk është dhe kjo mbi të gjitha demton imazhin e presidentit.

"Kjo është ndoshta Zonja e Parë më e paangazhuar që kemi pasur në epokën moderne. Është pak vonë për të që të dalë tani në skenë. Nuk është sjellja tipike që ne kemi parë te Zonjat e tjera të para. Asaj i mungon iniciativa". (The Guardian)

## 30 fëmijë të vdekur në sulmin e Kunduzit të Afganistanit

Misioni i Kombeve të Bashkuara për Asistencë në Afganistan (UNAMA) njoftoi se në sulmin ajror që ndodhi më 2 prill në krahinën Kunduz në veri të Afganistanit, kanë humbur jetën 30 fëmijë. Në raportin e publikuar nga UNAMA thuhet se 30 fëmijë kanë humbur jetën dhe se 51 të tjerë janë plagosur si pasojë e bombardimeve ndaj medresesë në qarkun Dashti Arçi. Në raport thuhet se në rajonin e sulmuar nga avionët e Forcave Ajrore të

kryesuar nga SHBA-të nuk është arritur në rezultat të sigurt se në rajon ndodhen apo jo terroristët. Gjithashtu theksohet se si pasojë e rritjes së sulmeve ajrore ka rritje edhe në numrin e të vdekurve civilë. Në një sulm ajror ndaj medresesë në Dashti Arçi më 2 prill, 100 persona kishin humbur jetën. Ministria e Punëve të Brendshme të Afganistanit kishin njoftuar se ata që humbën jetën si pasojë të sulmit janë militantë talebanë.





REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 44/2018

për punësimin e 18 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë “për vendet e punës në vijim:

1.AVR0102B02002 Udhëheqës i Qendrës 1 realizues(ë)  
për punësim të Qytetit të Shkupit

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, shkenca ekonomike ose shkenca organizuese dhe menaxhim(menaxhment)
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 36.430,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2.AVR0102B02001 Udhëheqës i sektorit 1 realizues(ë)  
për avancim dhe zhvillim të burimeve njerëzore

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 36.430,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3.AVR0102B03001 Udhëheqës i Qendrës 1 realizues(ë)  
për punësim - Tetovë

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lart
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 31.305,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4.AVR0102B03001 Udhëheqës i Qendrës 1 realizues(ë)  
për punësim - Strumicë

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lart
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 31.305,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

5.AVR0102B0001 Udhëheqës i Qendrës 1 realizues(ë)  
për punësim - Kumanovë

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lart
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 31.305,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

6.AVR0102B03001 Udhëheqës i Qendrës 1 realizues(ë)  
për punësim - Veles

### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të



13. AVR0102B04002 Udhëheqës i Qendrës për punësim - Kratovë 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lartë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

14. AVR0102B04002 Udhëheqës i Qendrës për punësim - Kriva Pallankë 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lartë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

15. AVR0102B04002 Udhëheqës i Qendrës për punësim - Probishtip 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lartë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

16. AVR0102B04002 Udhëheqës i Qendrës për punësim - Strugë 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Arsim i lartë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

17. AVR0102B04003 Udhëheqës i njësisë për kryerje revizore të ligjshmërisë së punës, Sektori për revizion të brendshëm 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

- trajnim të kryer dhe të dhënë provimin për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik ose certifikatë për revizion të pranuar ndërkombëtare

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

18. AVR0102B04003 Udhëheqës i njësisë për sigurim në rast të papunësisë, Sektori për sigurim dhe të drejta në rast të papunësisë 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.277,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.







## “Xhinset” që kushtojnë 168 dollarë

Një kompani nga Los Angelesi ka vënë në shitje një palë xhinse të reja që kushtojnë 168 dollarë. Carmar Denim debutoi me “Extreme Cut Out Pants” të cilat nuk kanë material dhe vënë në dukje tërë pjesën e poshtme të trupit. Nejsë, ka material vetëm për xhepat. Që prej publikimit të fotografive për xhinset e reja, kompania ka marrë kritika të ashpra për çmimin e tyre të cilat nuk kanë material. “Uau! Pse t’i veshim këto?”, ka pyetur një person në Instagram. “Nuk do të paguaja kurrë për xhinse të tilla”. Një tjetër bëri edhe më shumë shaka: “Të paktën paskan xhepa!”. “Me këto xhinse kontrollat e sigurimit në aeroport kalohen shumë lehtë”, vulosi një tjetër me komentën e tij.



# NJË KISHË NË ARABINË SAUDITE

Lajmi i përhapur në mediat e Lindjes së Mesme as është konfirmuar, por as mohuar si nga Vatikani, ashtu edhe nga Arabia Saudite. Arabia Saudite është i vetmi vend në rajon që nuk ka kishë për të krishterët. Vendi i lejon që të hyjnë për çështje pune, biznesi apo turizmi, por u ndalon praktikimin e besimit të tyre fetar në publik

Ata pak të krishterë që jetojnë ende në Arabinë Saudite dhe të tjerët që udhëtojnë në këtë vend nuk u lejohet që të praktikojnë besimin e tyre në publik, të paktën deri më tani. Mediat në Lindjen e Mesme flasin për një ndryshim drastik. Sipas tyre, Riadi ka rënë dakord me Vatikanin për ndërtime



min e një kishë katolike. Marrëveshja thuhet se është nënshkruar gjatë vizitës së Kardinalit Jean-Louis Tauran, i cili u takua në Mbretërinë Saudite me Abdel Karim Al-Issa, kreu i Ligës Myslimane. Vizita është zhvilluar këtë vit dhe veç klerikut të lartë mysliman, Kardinali i Vatikanit është takuar edhe me anëtarët e familjes mbretërore, ku mësohet se u ka kërkuar që të trajtojnë qytetarët e krishterë të vendit të tyre në barazi të plotë.

Lajmi i përhapur në mediat e Lindjes së Mesme as është konfirmuar, por as mohuar si nga Vatika-

ni, ashtu edhe nga Arabia Saudite. Arabia Saudite është i vetmi vend në rajon që nuk ka kishë për të krishterët. Vendi i lejon që të hyjnë për çështje pune, biznesi apo turizmi, por u ndalon praktikimin e besimit të tyre fetar në publik.

Organizata të të drejtave të njeriut dalin shpesh me raporte, ku thonë se ata pak të krishterë që jetojnë në Arabinë Saudite, zakonisht shfrytëzojnë rrjetet sociale, ku grumbullohen në biseda private për të praktikuar besimin e tyre. Vatikani ka shprehur më shpesh dëshirën për të financuar ndërtime

min një kishë në Arabinë Saudite dhe mesazhi që ka përcjellë shpesh është se si të krishterët, ashtu edhe myslimanët kanë dy armiq të përbashkët; ekstremizmin dhe injorancën. Kardinali Jean-Louis Tauran konsiderohet si një nga zërat më të vendosur të Vatikanit në promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit me islamin. Gjatë vizitës në Riad ai është takuar edhe me Princin e Kurorës, Mohammed Bin Salman, i konsideruar si njeriu që qëndron pas ndryshimeve drastike dhe hapjes së shoqërisë ultrakonservatore sunite.

## Aston Martin së shpejti vjen me nëndetëse

Zyrtarisht ka filluar prodhimi i projektit Neptune, i një nëndetëseje të vogël me vlerë prej 3.3 milionë dollarë, të cilën kompania e njohur Aston Martin e ka zhvilluar në partneritet me kompaninë Triton Submarines.

Fjala është për një nëndetëse e cila mund të zhytet deri në 500 metra thellësi dhe mund të lëvizë nën ujë me një shpejtësi prej



5 nje (9.2 kilometra në orë). Nëndetësja Neptune do të ketë baterinë me kapacitet prej 30 kWh, me të cilën do të mund të punojë deri në 12 orë me vetëm një mbushje, si dhe do të peshojë 4,000 kilogramë. Gjithashtu, do të ketë hapësirë për tre persona ku për ta do të ofrojë shumë rehati, duke përfshirë edhe kondicionerin.

## Letra prekëse e 85 vjeçarit: Kërkoj dikë të më adoptojë

“Unë nuk dua të shkoj në një shtëpi të moshuarish. Shpresoj që një person ose familje me dashamirësi të më pranojë, të më ushqejë me pleqëri dhe të varros trupin tim kur të vdes”. Ai vendosi letrën në një stacion autobusi në lagjen e tij dhe më pas shkoi në shtëpi të priste

Han Zicheng i mbijetoi pushtimit japonez, luftës civile kineze dhe Revolucionit Kulturor, por ai e dinte se ai nuk mund të duronte



dhimbjen e të jetuarit i vetëm. Dhjetorin e kaluar, 85-vjeçari mbledhi disa copa letre dhe shkroi: “Kërkoj dikë që të më adoptojë”.

“Njeri i vetmuar në të 80-at. Trup i fortë. Mund të bëj pazarin, të gatuj dhe të kujdeset për veten. Nuk vuaj nga asnjë sëmundje kronike. U tërhoqa nga Instituti i Kërki-

meve në Tianjin me një pension mujor prej 700 dollarë”, shkroi ai në letër. “Unë nuk dua të shkoj në një shtëpi të moshuarish. Shpresoj që një person ose familje me dashamirësi të më pranojë, të më ushqejë me pleqëri dhe të varros trupin tim kur të vdes”. Ai vendosi letrën në një stacion autobusi në

lagjen e tij dhe më pas shkoi në shtëpi të priste. Han ishte i dëshpëruar për shoqëri. Ai tregoi se gruaja e tij kishte vdekur dhe se me fëmijët nuk kishte kontakte. Fqinjët e tij kishin fëmijë për të rritur dhe prindërit e tyre të moshuar për t’u kujdesur. Pavarësisht se shumë u interesuan për rastin e tij, madje një restorant i ofroi ushqimin falas, askush nuk u ofrua të jetonte me të. Asaj që ai i trembej më shumë ndodhi, Han humbi jetën në muajin mars, duke arritur vetëm të njoftonte spitalin. Standardet e përmirësuar të jetesës dhe politika e vetëm një fëmijë, kanë rrëzuar piramidën e shoqërisë kineze. Tashmë, 15 për qind e kinezëve janë mbi 60 vjeç. Deri në vitin 2040-ën, do të jetë raporti një në katër, sipas parashikimeve aktuale.

## NËÇAIR ZHVILLOHET NDESHJA E MBETUR MES SHKUPIT DHE PELISTERIT

"Unë pres një ndeshje të vështirë, pasi që edhe për Pelisterin, ndoshta është gjasa e fundit për mbijetesë dhe të mbeten në Ligën e Parë. Do të përsëris, ne nuk kemi të drejtë të kalkulojmë, të bëjmë kiks, nëse dëshirojmë që të mbetemi në luftë për vendin e tretë ose të katërt që sjell kualifikim për Evropë



# NUK KEMI TË DREJTË TË GABOJMË NËSE DËSHIROJMË TË LUAJMË NË EVROPË

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 8 maj - Skuadra e FC Shkupi sot (e mërkurë) në stadiumin në Çair do të zhvillojë ndeshjen e mbetur të javës së 26 ndaj Pelisterit. Ndryshe, kjo do të jetë njëra nga dy duelet që do të zhvillojnë këto dy ekupe, pasi ato do të përballen njëra kundër tjetrës në Manastir në javën e parafundit të Ligës së parë futbollistike të Maqedonisë. Për të dyja skuadrat pikët janë më se të nevojshme, andaj pritet të zhvillohet një "luftë" e madhe në fushën e gjelbër. Favorit në letër janë bardhekaltërit, por atë duhet ta dëshmojnë në fushë, derisa nuk kanë të drejtë të gabojnë, pasi në të kundërtën do të humbin gjasat për plasman në Liga Evropë. Sulmuesi i FC Shkupi, Bllazhe Ilijoski pranon se përballja me Pelisterin

do të jetë e vështirë, pasi sipas tij edhe skuadra nga Manastiri sot do ta ket mundësinë e fundit për mbijetesë në Ligën e parë. "Unë pres një ndeshje të vështirë, pasi që edhe për Pelisterin, ndoshta është gjasa e fundit për mbijetesë dhe të mbeten në Ligën e Parë. Do të përsëris, ne nuk kemi të drejtë të kalkulojmë, të bëjmë kiks, nëse dëshirojmë që të mbetemi në luftë për vendin e tretë ose të katërt që sjell kualifikim për Evropë. Një gjë e di që se sot duhet të japim maksimumin dhe shpresoj që do të festojmë fitoren së bashku me 'Shvercerët' dhe do të gëzohemi atyre tre pikëve të mëdha me të cilat, duke ditur se çfarë duele kanë kundërshtarët, do të na hapen rrugët për në Evropë", u shpreh Ilijoski. Ai thotë se ai dhe shokët e skuadrës nuk janë nën presion.

"Nuk kemi presion, mirëpo vetëm duke menduar se nga nga katër ndeshje na duhen 12 pikë sjell vetë presion. Edhe për ndeshjen e sotme e dimë se vjen ekipi në fund të tabelës dhe këto ndeshje sipas eksperiencës time janë ndeshjet më të vështira, pasi pres që ata të shtrihen, që të mos lejojmë të ketë futboll dhe vetëm kjo mund të na nxjerr nga binaret. Mendoj se me gol të shpejtë do të mbarojmë punën", shtoi më tej sulmuesi i Shkupit. Kur jemi te referimi, Ilijoski thotë se ndaj Pelisterit nuk do të përsëritet i njëjti skenar si me Sileksin. "Shpresoj se nuk do të ketë skenar si me Sileksin dhe referët do të shpejtojnë ndeshjen dhe nuk do të lejojnë që të bëjnë një gjë të tillë, që të na nxjerrin nga binaret". Në fund Ilijoski bën edhe matematikat e tij sa i përket pla-

smanit në Liga Evropë. "Të kishim shënuar fitore të dielën ndaj 'Skopjes', 90 për qind do të ishim në Evropë. Dhe mund të them se ndoshta edhe 100 për qind. Me atë fitore ndaj 'Skopjes', gjithçka do të varej nga ne dhe tani nuk varet gjithçka nga ne. Aq sa varet nga ne, varet edhe nga të tjerët, ashtu që ky është i vetmi problem. Edhe nëse fitojmë të gjithë ndeshjet, do të varej edhe nga kundërshtarët. Andaj nëse shënonim fitore ndaj 'Skopjes', asgjë nuk do të varej nga ata, dhe gjithçka do të varej nga ne. Unë jam një optimist i madh dhe shpresoj se ashtu do të bëhet dhe ne do të jemi në garat evropiane", përfundoi Ilijoski. Ndeshja Shkupi - Pelisteri zhvillohet në stadiumin në Çair me fillim në ora 16.30.

## Kontratë e re si shpërblim për formën e lartë

Sulmuesit i Përfaqësueses së Kosovës, Atdhe Nuhiu, që në ndeshjet e fundit është shndërruar në hero të tifozëve të Sheffield Uensdej, ka pranuar se negociatat për kontratën e re me ekipin nga Championship i Anglisë "po shkojnë në drejtimin e duhur", përcjell "The Star". Sulmuesit, 28-vjeçar, kontrata aktuale me Sheffieldin i skadon në fund të muajit të ardhshëm, kurse në klub janë të gatshëm që ta ndalin të paktën edhe për tre vjet të tjerë. Nuhiu ka shkëlqyer te Sheffieldi gjatë këtij viti, duke e mbyllur këtë edicion me "hat-trick" në ndeshjen e fundit ndaj Norviçit (5:1) të zhvilluar të dielën. Në total, Nuhiu gjatë këtij edicioni ka shënuar 14 gola (11 në kampionat, 3 në FA Cup) në 35 paraqitje në të gjitha garat.



## NJË JAVË NGA FUNDI I KAMPIONATIT Roshi gjen golin e parë

Odise Roshi ka gjetur rrugën e rrjetës me skuadrën e tij në kampionatin rus, Akhmat Grozni, në sfidën e luajtur pasditën e sotme ndaj Anzhi Makhaçkala. Mesfushori fierak i kombëtares shqiptare u aktivizua në fillim të pjesës së dytë, në vend të Bernard Berishës dhe shënoi në minutën e 87', duke vulosur rezultatin 0-2. Goli i Roshit erdhi pas një kundërsulmi të shpejtë të skuadrës çeçene, që kapi të papërgatitur mbrojtjen vendase, ndërsa portieri i Anzhi nuk mundi të ndalë gjuajtjen e anësorit fierak. Titullar në këtë takim ishte edhe sulmuesi shkodran i kuqezinjve, Bekim Balaj, që luajti për 66 minuta, por pa shkuar dot te goli. Skuadra çeçene, Akhmat Grozni, me këtë fitore siguroi përfundimisht mbijetesën në Premier Ligën ruse, kur ka mbetur edhe një javë për t'u luajtur.



## Bardhi sërish nga gjuajtja e lirë



Shkup, 8 maj - Futbollisti shkupjan Enis Bardhi po vazhdon shkëlqimin e tij me Levanten në kampionatin spanjoll, La Liga. Bardhi ka shënuar një gol të bukur nga gjuajtja e lirë në fitoren e Levantes 3 me 0 ndaj Leganes. Ylli shqiptar që mbron ngjyrat e Kombëtares së Maqedonisë, shënoi një gol të bukur në minutën e 59-të, një gol nga gjuajtja e lirë, duke vazhduar kështu serinë e golave pas atyre dy euro-golave ndaj Atletik Bilbaos. Dy golat tjerë për ekipin e Levantes i shënuan Koke dhe Morales. Ndryshe, ky ishte goli i shtatë i futbollistit shkupjan në sezonin e parë me ekipin spanjoll pas transferimit nga Ujpeshti. Ndryshe, ky është goli i shtatë nga Bardhi në sezonin e tij të parë si futboll-

ist në La Liga, teksa ka edhe një asistim. Në anën tjetër, për Bardhin ky ishte goli i pestë i shënuar nga goditja e lirë në këtë sezon, ashtu që kjo e vendosi në mesin e pesë futbollistëve të cilët kanë arritur të shënojnë pesë gola nga goditja e lirë në një sezon. Asnjë nga katër futbollistët e tjerë si Asunsao 5 gola nga 49 goditje, Pernia 5 nga 24, Ronadinho 6 nga 49 si dhe Messi sezonin e shkuar 6 gola nga 48 goditje. Bardhi sivjet ka shënuar 5 gola nga 16 goditje, arritje kjo të cilën nuk e kishte shënuar më parë. Bardhi është bërë pjesë edhe e historisë së skuadrës së Levantes. Ai në këtë sezon ka gjithsej 7 gola të shënuar, por është futbollisti i parë i kësaj skuadre që ka arritur të shënojë pesë gola nga goditjet direkt.



SUSO SIGURON

# ASGJË NUK MË SHTYN TË LARGOHEM NGA MILANI

“Unë gjithmonë e kam thënë se jam shumë mirë këtu në Milano. Nëse ekipi dhe klubi dëshirojnë të rriten me mua, do të jem i lumtur, sepse Milani është shtëpia ime. Po të mos ishte kështu, nëse në vend të rritjes, do të ishte një vit i tranzicionit, do ta kisha thënë”, pohon Suso

Ndër protagonistët kuqezinj me pritshmëritë më të mëdha në finalen e Kupës së Italisë, e cila do të luhet të mërkurën në mbrëmje, në “Stadio Olimpico” të Romës, sigurisht që është Suso. Spanjollli mori një goditje në ndeshjen kundër Verona, por planifikon të bëjë më të mirën kundër bardhezinjve. “Unë ende kam disa orë për ta rikuperuar lëndimin në kofshën e djathtë”, – tha futbollisti në fjalë për “Tuttosport”. – Fakti që kjo është një finale tepër e rëndësishme, nuk dua të mungoj kurrë, edhe pse e di se definitivisht, koha nuk është në favorin tim. Sezoni im ka qenë përgjithësisht pozitiv, Kupa e Italisë do të jetë si qershia mbi tortë, nëse e fitojmë. Sezoni e ardhshëm do të bëjë edhe më mirë”. Suso duket se e sheh veten të veshur me fanellën kuq-

zi edhe sezonin e ardhshëm: “Unë gjithmonë e kam thënë se jam shumë mirë këtu në Milano. Nëse ekipi dhe klubi dëshirojnë të rriten me mua, do të jem i lumtur, sepse Milani është shtëpia ime. Po të mos ishte kështu, nëse në vend të rritjes, do të ishte një vit i tranzicionit, do ta kisha thënë”, pohon Suso. Para se të mendojë për të ardhmen, Suso ka ende një finale për ta luajtur, të cilën do të përpiqet ta fitojë: “Ndeshja kundër Juventusit të karikon vetvetiu, – shtoi Suso. – Sigurisht, do të japim maksimumin për ta fituar këtë trofe. Jam i bindur se sezonin e ardhshëm mund të bëjmë kërcimin në cilësi. Fitimi i Kupës së Italisë do ta përfundonte rrugën e rritjes dhe do të na jepte besim të madh”. Edhe për shkak se performanca e fundit e Juventus nuk ishin emocionuese, titulli i 7-të radhazi është tani një formalitet për “Zonjën e Vjetër”. “Ne themi se kohët e fundit, Juvja ka luftuar pak, – pranoi Suso, – por është, gjithashtu, e vërtetë se në fund e sollim në shtëpi trofeun e kampionit”, përfundoi Suso.



Fitimi i Kupës së Italisë do ta përfundonte rrugën e rritjes dhe do të na jepte besim të madh”. Edhe për shkak se performanca e fundit e Juventus nuk ishin emocionuese, titulli i 7-të radhazi është tani një formalitet për “Zonjën e Vjetër”



## Ikën Grizmann, vjen Di Maria

Angel Di María mund të jetë një nga përforcimet luksoze të Atletico Madrid për sezonin e ardhshëm, njofton “Cadena SER”. Lojtari argjentinas duket se është ofruar për ta përforcuar klubin e trajnerit Diego Simeone, ndaj menaxheri i tij ka udhëtuar në Madrid për t'u takuar me drejtuesit. Futbollisti i Albiceleste ka qenë gjithmonë një pëlqim i Simeones, ndërkohë që ka veshur fanellat e skuadrave të tilla si Real Madridi, Manchester Junajtedi dhe Paris Sen Zhermeni. Me largimin e pothuajse të caktuar të Grizmann, Atletico Madrid është në kërkim të një figure, me të cilën i nxehtë tifozët e vet. Di Maria mund të jetë një bast i sigurt. Sipas “Cadena SER”, Andrea Bertta, drejtori sportiv i Atletico, ka folur me përfaqësuesit e lojtarit, për të filluar negociatat. Në hijen e Mbappe, Kavani dhe Nejmar, Di Maria, i cili e sheh veten jashtë kontratës në qershor 2019, do ta mirëpriste një ndryshim ajri, aq më tepër kur bëhet fjalë për një klub, që po lufton në sezonet e fundit me të mëdhenjtë e Spanjës dhe ka synuar e fituar tituj në Evropë. Në favor të transakcionit, gjithashtu, përmendet fakti se klubi parisien do të duhet të shesë disa nga yjet e veta këtë verë, që të përballlet me “fair-play financiar”, çka është e detyrueshme për t'u përmbushur.

## Levandovski dhe Vidal mund të shiten në verë

Bajern Muni duket se është gati të shesë Robert Levandovskin dhe Arturo Vidal. Sulmuesi 29-vjeçar është transferuar te bavarezët nga Borussia Dortmundi në verën e 2014-ës me kosto zero. Që nga ajo kohë, ai është bërë një nga sulmuesit më të mirë në botë. Vidal është transferuar në Gjermani një verë më vonë

dhe është një nga mesfushorët më të mirë në botë për momentin. Tani, Bajerni po mendon t'i shesë të dy këta lojtarë në merkaton e ardhshme. Objektivi i kampionëve të Gjermanisë është të kthehen të dominojnë në “Champions League”. Kështu, pasi kanë siguruar Leon Goretzkan, ata do të kërkojnë të marrin

njërin mes Antoine Griezmann, Paulo Dybalan apo Entoni Martial. Nëse kjo ndodh, klubi do ta shesë Levandovskin, kontrata e të cilit, ashtu si ajo e Vidal, skadon në verën e 2019-ës. Duke parë se Leva ka shumë oferta të rëndësishme dhe Vidal është shumë i kërkuar në Itali, të dy mund të shiten në verë.



Publicitet



KOMUNA E KARPOSHIT  
SEKTORI I EKOLOGJISË DHE EFIKASITETIT ENERGETIK



## LAJMËRIM

Bashkëqytetar të nderuar,

Ju informojmë se aksioni për subvencionim për blerje të biçikletave të reja të cilën e ka realizuar Komuna e Karposhit ka përfunduar, për shkak të harxhimit të mjeteve financiare. Duke patur parasysh faktin se kuota për subvencionim është plotësuar, vetëqeverisja lokale prej ditës së martë (08.05.2018) nuk do t'i merr parasysh aplikacionet e arritura. Në rast se parashihen mjete të reja për këtë qëllim, do të informoheni me kohë përmes rrjeteve sociale dhe Facebook profilit të Komunës së Karposhit, si dhe përmes mediave të shtypit.

FLET TRI GJUHË DHE MBAN NUMRIN E ZANETTIT

# NOLAN, IRLANDEZI QË PO ÇMEND AKADEMINË E INTERIT

Nolan është një mbrojtës te primavera e Internazionale dhe ëndrra e tij është të kalojë në ekipin e parë të fanellës së famshme Zikaltër, si Liam Brady dhe Robbi Kin përpara tij. Ai gjithashtu do të kishte shumë dëshirë të përfaqësonte ngjyrat irlandeze një ditë

Nuk ka shumë irlandezë 19-vjeçare që flasin tri gjuhë të huaja dhe që kanë si objektiv të luajnë në një prej klubeve më të mëdha në botë. Kështu që Rajan Nolan është një njeri i veçantë. Historia e tij ka filluar në Shannon, ai është zhvilluar në Spanjë dhe tani synon të luajë në "San Siro". Nolan është një mbrojtës te primavera e Internazionale dhe ëndrra e tij është të kalojë në ekipin e parë të fanellës së famshme Zikaltër, si Liam Brady dhe Robbi Kin përpara tij. Ai gjithashtu do të kishte shumë dëshirë të përfaqësonte ngjyrat irlandeze një ditë. Eksperiencat e kaluara e bëjnë një lojtar të pazakontë, njohuria e gjuhëve të huaja e kanë ndihmuar në fushën e lojës për të fituar be-tejat me kundërshtarët. "Ndonjëherë nuk do t'i flisja në Italisht por në Spanjisht apo Anglisht," shprehet Nolan. "Ata kthejnë kokën dhe nuk e dinë se çfarë kam thënë. Janë lojërë psikologjike", vazhdon më tej Nolan.

Nolan është rritur në Shannon,



Kounty Klare, dhe theksin e asaj zone nuk e ka humbur, megjithëse ka jetuar jashtë shtetit që prej moshës 8-vjeçare. Familja e tij bënte pushimet në Murica çdo verë dhe një vit vendosi të shpërngulej përfundimisht, duke u transferuar në Torre Paçeko. "Kisha shokë në Irlandë dhe transferimi ishte pak i frikshëm. Në fillim nuk doja të shkoja por më pas mësova gjuhën dhe bëra shok të rinj dhe ka qenë një eksperiencë e bukur", vazhdon më tej rrëfimin Nolan. Më pas ai vazhdoi të përmirësohej dhe zgjodhi të përfaqësonte Murcian, duke luajtur në një turne madhor për moshat U-16 ndaj regjioneve të mëdha spanjole

le si Madrid dhe Katalonia. "Aty kishte shumë vëzhgues dhe skautët e Interit më zbuluan". Derisa, ai është zbuluar nga legjendari Pierluigji Kasiragi, i cili ka zbuluar lojtarë si Balotelli dhe Kutinjo, dhe mendonte se Nolan do të ishte i përshtatshëm për lojën italiane. Stërvitja më e mirë e ka përmirësuar ndjeshëm Nolan, me seanca të ndryshme që fokusohen në aspektin kondicional, taktik dhe teknik. I gjatë dhe i fortë, Nolan mund të luajë kudo në prapavijë. Ai ka tërhequr vëmendjen e klubeve angleze, me Liverpoolin që thuhet të jetë një prej tyre. "Milano është një qytet i bukur. Ka shumë histori antike dhe dyqane për

shopping. Pas gati tre viteve këtu i di të gjitha vendet e rëndësishme". Pas tre viteve, ai ka filluar të tërheqë vëmendjen e ekipit të parë të Inter, duke u thirrur në seancat stërvitore nga trajneri Luciano Spalletti dhe duke u përballur me lojtarë si Mauro Ikardi dhe Ivan Perišić. "Kur markoj Ikardin dhe Perišić është një detyrë e madhe por më ndihmon të mësoj. Nëse markon ata mund të markosh këdo në botë. Mund të them se Ikardi sidomos, ka lëvizshmëri fantastike. "Jam stërvitur disa herë me ta por dua të bëj hapin e madh dhe të luaj përkrah tyre. Të luaj për Irlandën është një tjetër ëndërr për mua".

RIVALITETI LIHET MËNJANË



## Iniesta ia dhuroi fanellën e tij Ramosit

Sergio Ramos vendosi mënjane rivalitetin e Real Madridit me Barcelonën për t'i dhënë nderimet maksimale Andres Iniestas, ndaj të cilit luajti "El Clasico" e fundit. Kjo, për shkak se mesfushori kreativ do të largohet nga skuadra katalanase në fund të këtij sezoni, ndërsa destinacioni i ardhshëm duket se do të jetë Kina. Iniesta luajti për herë të fundit si kapiten i Barcelonës në një ndeshje kundër "Los Blancos", në përplasjen e diskutueshme të së dielës, ku u regjistrua barazimi 2-2 dhe Roberto u dëbua me karton të kuq në fund të pjesës së parë. Dhe, ndërsa të dyja ekipet kishin arsye për zhgënjimin në kohë të plotë, kapiteni i Real Madridit, Ramos, gjeti kohë për të lavdëruar Iniesta, një shok ndërkombëtar me Spanjën. "Përtej asaj që ndodhi në fushë, ndeshja e mbrëmshme do të mbahet mend si klasika e Iniestës", – ka shkruar Ramos në "Twitter", të hënën, së bashku me një foto të tij, duke mbajtur fanellën e mesfushorit katalanas. – Ju do të më mungoni, miku im". Iniesta pritet të shkojë në Superligën Kineze në fund të sezonit, por për momentin përqendrimi i tij mbetet te kampionët e Barcelonës, për t'i dhënë fund këtij kampionati të La Ligas si të pamposhtur.

LAJMI I SHUMËPRITUR

## Ferguson del nga koma dhe flet me familjarët

Më në fund lajme të mirë për Sër Aleks Ferguson, që ka dalë nga koma ku ndodhej prej dy ditësh, pas ndërhyrjes në tru në "Royal Hospital". Të shtunën ai pati një hemorragji cerebrale dhe iu nënshtrua një operacioni me urgjencë, por tashmë situata duket drejt përmirësimit. Në buletin mjekësor që kanë nxjerrë mjekët e spitalit shprehet se Ferguson flet me miqtë e familjarët, madje edhe është ngritur nga shtrati për disa minuta. Në krah të 76-vjeçarit Ferguson është gjithnjë bashkëshortja e tij Kethy, ndërkohë që mjekët kanë mbetur të kënaqur nga si nga operacioni ashtu dhe nga mënyra se si po shkon situata post-operacion. Ndaj



optimizmi se Sër Aleks do të rikthehet si më parë është i madh edhe pse rruga që trajneri i njohur i Manchester Junajted është ende e gjatë. Pas lajmit se Ferguson është shtruar në spital nuk kanë munguar mesazhet e mbështetjes për trajnerin skocez.

## Televizioni iranian censuron arbitren gjermane

Pjesëmarrja e arbitres femër Bibiana Steinhaus në ndeshjen e Bundesligas gjatë fundjavës së kaluar mesa duket nuk është diçka që pranohet nga televizioni iranian. Kjo pasi regjia është përpjekur gjatë gjithë kohës të fshehtë drejtuesen e ndeshjes në ndeshjen mes FC Koln dhe FC Bajern. Të shtunën e kaluar Steinhas ka drejtuar ndeshjen mes Koln dhe Bajern. Ndeshja nuk është transmetuar vetëm në Gjermani, por edhe në Iran. Por mesa duket shikuesit iranianë nuk duhet të shihni arbitren femër teksa fërshëllente ndeshjen. Iranianët kanë censuruar pamjen e saj sikur të ishte një film pornografik. Censura është zbuluar nga një gazetarë e ARD: Ishte një ndeshje e çuditshme mjeshtrit e censurës në Iran. Bibiana është shfaqur vetëm gjatë



pamjeve nga lart, dhe sa herë që pamjet ishin nga afër, ajo censurohej," shkruante në "Twitter" Natalie Amiri.



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Kjo e martë nuk do të jetë aspak e favorshme për raportet ndërpersonale, e sidomos për ato në fushën e ndjenjave. Sa i takon dashurisë do të keni shumë kuriozitet dhe për rrjedhojë ndoshta mund t'iu lindë dëshira për diçka të re. Gjithsesi do të jetë inteligjenca juaj ajo që do të përmirësojë cilësinë e intensitetit në çift.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Kjo ditë do të jetë shumë e favorshme! Do të jetë mjaft stimuluese sa i takon dashurisë. Në raportin në çift pritet të ketë të reja të rëndësishme, ndonëse mund të bëhet fjalë për detaje të vogla. Pritet që të ketë dhurata të paparashikuara. Për ata që janë vetëm priten të reja interesante.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Ju të lindurve të kësaj shenje ju pret një e martë jo shumë e favorshme. Në dashuri, për të shmangur keqkuptimet, sidomos nëse raporti nuk ka shumë që ka nisur, bëni mirë të mos mbani sekrete. Ata që janë vetëm, po projektojnë nisjen e një lidhje të re, por mendohuni mirë para se të hidhni këtë hap. Në punë dita do të jetë mjaft e favorshme për të provuar eksperiencën tuaj.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Kjo ditë do të jetë shoqëruar gjatë gjithë kohës nga humori i mirë. Në dashuri, parashikohen mundësi të shumta për t'u shfrytëzuar, qoftë për çiftet që janë të konsoliduar, edhe për ata më pak solid. Përfitoni nga ky moment pozitiv, pasi yjet ju mbështesin në çdo nismë tuajën. Në punë, mos u bllokoni nga paragjykimet dhe frika e të tjerëve. Ju keni mjaft rezervë të fshehura.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Kjo ditë fillim javë, duhet zhdukur sa më parë. Do të përballeni me ndikimin negativ të Hënës. Në dashuri, do të jetë e vështirë që të shmangni debatet. Do e keni të ndaluar që të shijoni qetësinë që ju duhet për tu çlodhur. Bëni mirë që ti kushtoni më shumë kohë mirëqenies suaj fizike dhe mendore. Ata që janë vetëm, duhet të mbajnë distancë nga lidhjet e komplikuar.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Kjo e martë do të jetë e shkëlqyer në të gjitha aspektet. Do të jetë një ditë mjaft e qetë dhe tejet harmonike, sidomos në fushën sentimentale. Këshillohet që të veproni me maturi dhe do t'ia dilni të forconi lidhjen tuaj të dashurisë. Ata që janë vetëm, do të bëjnë njohje të reja, mjaft interesante. Në sferën profesionale, ndonëse do të keni një vullnet absolut.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Kjo e martë do të nisë në mënyrën më të mirë të mundshme, për të lindurit e kësaj shenje. Në dashuri, askush nuk do ju pengojë në realizimin e programit tuaj, duke bërë që dita të kalojë në relaks të plotë. Ata që janë vetëm, do e kalojnë ditën duke u marrë me një projekt që e kanë për zemër. Parashikimi i ditës, kërkon që të jeni më të hapur ndaj miqësive të reja.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Dita do të nisë në një mënyrë jo shumë pozitive. Në dashuri, kjo ditë nuk do të jetë në ritmet e duhura. Ajo që këshillohet për ju është që të mos tregoheni shumë kokëfortë. Ata që janë vetëm, do të kenë mundësi për një njohje të re, e cila do i bëjë që të ndihen të vlerësuar. Në punë, mundohuni që të ruani qetësinë dhe jini korrekt me kolegët tuaj.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo ditë do të jetë mjaft eksituese, sidomos sa i takon dashurisë. Në raportin në çift, bëni mirë që të sqaroni çfarë ju shqetëson. Në të kundërt, rrezikoni që raporti me partnerin/en, të shoqërohet me grindje pa fund. Kush është vetëm, do të ketë takime me njerëz të rinj. Sa i takon punës, kjo do të jetë një ditë plotë energji dhe përqendrim.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Një ditë aspak e keqe kjo e martë! Në dashuri, yjet do të stimulojnë emocione të forta. Tregohuni të arsyeshëm me personin që doni dhe lidhja do të jetë më se e mirë. Ata që janë vetëm, do të dinë si të joshin dikë që e kanë për zemër. Në punë, do të përfshihen nga situata që do ju mbajnë tejet të angazhuar. Mos u dorëzoni, inteligjenca juaj krijuese do ju çojë drejt suksesit të sigurtë.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Ju pret një ditë e mbushur me pasiguri. Në fushën e ndjenjave, yjet favorizojnë realizimin e disa dëshirave tuaja. Në disa momente të ditës do të shoqëroheni nga një ndjesi e mirë mirëqenie, ku do të përfshihet edhe partneri/ja juaj. Ata që janë vetëm, duhet të reflektojnë mirë rreth një personi gjatë kësaj të marte. Sakaq në punë, mundohuni të tregoni siguri të tepruar.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Kjo ditë e javës, do të jetë mjaft e mbarë për të lindurit e kësaj shenje. Sa i takon dashurisë, yjet do ju ndihmojnë në realizimin e ëndrrave tuaja. Jeta në çift do të jetë shumë e zjarrtë dhe në disa momente edhe speciale, ku do të keni nevojë për emocione dhe sfida të reja, shumë prej të cilave kanë të bëjnë me të ardhmen tuaj bashkë.

**SOT NJË VIT PA TY, GËZIMI DHE JETA E FAMILJES SONË**



**ILIRJANA**  
**Dika-Baftijari**  
13 prill 1970 - 9 maj 2017

Çdo herë që mendojmë për Ty, zemra na mbushet me krenari, meqë ishe një bijë, motër, kumatë dhe një hallë e përkryer në çdo aspekt të jetës sonë, prandaj gjithmonë je dhe do të jesh e gjallë në zemrat dhe kujtimet tona.

Me mall dhe dashuri të pashuar të përkujtojnë: Baba Pëllumb, nëna Arzije, vëllai Arianit, kunata Elvadina, mbesat Bora dhe Ejona dhe nipi Ari.

**SOT NJË VIT PA BUZËQESHJEN DHE DASHURINË TËNDE ILIRJANA-MAMI.**



**ILIRJANA**  
**Dika-Baftijari**  
13 prill 1970 - 9 maj 2017

Kujtimi për Ty do të mbetet gjithnjë në shpirtin tonë, pasi ishe një bashkëshorte e përkryer, ishe një nënë shembullore, ishe një yll që gjithmonë rrezatoje dritë për ne, fëmijët e tu, që kurrë nuk na le vetëm, prandaj mungesa jote do të jetë plagë e pa shëruar në zemrat tona, Mami.

Të përkujtojnë: Bashkëshorti Agni, djali Genti dhe vajza Rina.

Mensur Mamuti	KOMPANI ANGLEZE E PRODUKTEVE HIGJENIKE	POLITIKANI SHQIPTAR, FATOS	XHJDIJSTJA NË FOTO I FITON VETËM MEDALJET E ...	KOHA	PËRPIJUESI I FJALORIT ANG-SHQ, QESKU KOMPOZIT. ITALIAN, FERDINANDO	P	HEROINA KOSOVARE NË FOTO	FOSFORI	VEGËL MUZIKORE ME KATER PALE TELA	VEND NË BRAZIL, MEDALJA E ARTË NË LOJËRAT OLIMPIKE 2017 DHE KAMPIONATIN BOTËROR 2013
KËNGËTARJA OKSA				TREN SHANI PALLASKA						
VEND NË POLONI MEDALJA E ARTË NË KAMPIONATIN EVROPIAN NË 2017 DHE FRANÇË 2014							PËREMËR PRONOR SHKURTESA PËR 'EINSTEIN'			
M									OKSIGJENI TAKIMI I MIQËVE PËR NJË GËZIM	
ISH TENISTI FRËNG, JANIK				LIND PËRSËRI						
					LIDHJE QELIZASH TË NJËLLOJTA					
					AZOTI		E. ZH. PJESËTAR I AZUREVE			
					VËLLAU I NËNËS					
					VEND NË RUSI, MEDALJA E ARTË NË KAMPIONATIN EVROPIAN 2014					
K										
PËRREMËR PYETËS KOMPOZITORI I TILIAN, XHUZEPE								SPANJA LLOJ ÇIPSI AMERIKAN		
V										
LITRI							AR (FRËNGJ.) EMRI NË ORIGINAL I AKTORIT FRËNG, DELON			
AKTORE DHE KËNGËTARE AMERIKANE (KABARE)	BAR, MEDIKAMENT	SHKENCËTARJA BOSHNJAKE, ZLATA KËMBANË	B	METRI	LLOJ LIKERI ZLATAN IBRAHIMOVIQ					
L										NGJYRË (ANG.)
'MBRETI' I SHEKSPIRIT				RAJON NË HUNGARI, SERBI DHE RUMANI ALBERT JANKU						
SIMBOL I SAKRIFICËS DHE I FLUJIMIT							KËNGËTARJA KANADEZE, SELIN BELGJIKA			
VEND NË RUSI, MEDALJA E ARTË NË KAMPIONATIN BOTËROR 2013										

ZGJIDHJET: P, ANA, PAMPUR, VARSHAVA, TI, MONTEPELJE, O, NOA, RILIND, INDE, N, EZH, DAJA, KAZAN, KU, E, VERDI, L, OR, B, AMARO, LIZA MINELLI, LIR, BANATI, ALTAR, DION, ÇELJABINSK

# Të mirat e kosit shtëpiak

Specialistët nënvizojnë rëndësinë e konsumimit të qumështit dhe kosit. Ata pohojnë se kosi i përgatitur në shtëpi është një mbrojtës i mirë ndaj sëmundjeve. Duhet kërkuar rrugë alternative për ta mësuar fëmijën me kosin dhe për ta bërë këtë mund të përdoren pekmezi, mjalti dhe frutat. Kosi i zënë në shtëpi është më efektiv se kosi i gatshëm në mbrojtjen ndaj sëmundjeve. Duke marrë parasysh faktin se fëmijët janë në një proces rritjeje dhe zhvillimi, atyre u duhen ndaluar pijet e gazuara. Dhalli zëvendëson shumë mirë konsumimin e pijeve të gazuara duke nënvizuar vlerat e kosit i cili është



lënda bazë e saj. Ka vende të ndryshme në Evropë dhe SHBA të cilat e konsumojnë kosin si një vakt më vete për një jetë më të shëndetshme. Ndërsa te ne kosi preferohet të konsumohet në shoqërinë e

ndonjë gjelle. Prindërit duhet të tregohen të kujdesshëm në mësimin e fëmijëve me konsumimin e kosit. Ai është një burim i mirë proteinash dhe ka një strukturë e cila është burim kalciumi dhe një masë

mbrojtëse ndaj infeksioneve të zorrëve dhe atyre urinare. Për të mësuar fëmijët me kosin mund të përdorni frutat, mjaltin ose pekmezin. Fara e kosit e përdorur në fabrikë nuk është e njëjtë me atë të shtëpisë. Por duke marrë parasysh faktin se brezi i ri sa vjen e largohet nga tradicionalja dhe nuk ia ka idenë sesi zihet kosi, ne nuk i themi "jo" kosit të gatshëm. Krahas kësaj, konsumimi i qumështit nga fëmijët është shumë i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Veçanërisht fëmijët mbi 7 vjeç duhet të pinë të paktën dy gota qumësht në ditë, një në mëngjes dhe një gotë para se të flenë.

## Për shkak të mbiemrit të gjatë, u detyrua të bëjë pagesë shtesë për biletë

Aviokompania Thai Airways e ka detyruar një udhëtar të bëjë pagesë shtesë për biletë, për shkak të mbiemrit të gjatë, raportuan të shtunën mediat botërore. Zyrtarja me rastin e kontrollit të biletës e detyroi pasagjerin anonim të bëjë një pagesë shtesë, meqë konstatoi se mbiemri i tij në pasaportë nuk përputhej me atë në biletën e avionit, shkruante Bangkok post. Udhëtarit sqaroi se për këtë kishte arsye të madhe. Mbiemrin e ka shumë të gjatë dhe ka qenë e pamundur të përfshihej mbiemri i plotë në formularin e internetit për shkak të hapësirës së kufizuar ku shënohet e dhëna, transmeton Koha.net. Kompania ka njoftuar se në të ardhmen do të ndër-marrë masa përkatëse që rasti të mos përsëritet. "Kërkojmë falje për këtë shqetësim. Formulari, të cilin udhëtarët e plotësojnë kur e blejnë ose e rezervojnë avio-kartën, ofron hapësirë për 25 shkronja në rubrikën 'Emri' dhe në rubrikën 'Mbiemri', kishte shkruar zyrtari i kompanisë, citojnë mediat.

## Unaza që futet në vaginë dhe të mbron nga HIV-i

Kostoja për të parandaluar transmetimin e virusit HIV, nëpërmjet një instrumenti të ri është 5 dollarë. Bëhet fjalë për unazën vaginale, protagoniste të dy studimeve me rastin e Conference on Retroviruses and Opportunistic Infection në Boston, SHBA. Studimi i parë i titulluar "Use of a Vaginal Ring Containing Dapivirine for HIV-1 Prevention in Women", u publikua në revistën shkencore 'New England Journal of Medicine', ndërsa i dyti nuk ka dalë ende, por pritet të publikohet së shpejti. Por ku konsiston kjo unazë? Bëhet fjalë për një diapozitiv që çliron dapivirinë dhe që interferon me virusin HIV, duke penguar përhapjen e tij. Nuk bëhet fjalë për një risi të mirëfilltë, pasi studiuesit po punojnë prej vitësh, por vetëm tani studimet kanë zbuluar efikasitetin. Studimi i parë u bë mes gushtit të vitit 2012 dhe qershorit të vitit 2015 në 2629 gra me moshë nga 18 deri në 45 vjeçe në Malawi, Afrikën e Jugut, Ugandë dhe Zimbabve. Pjesëmarrësit në studim u



ndanë në dy grupe, ku grupit të parë iu vendos anela vaginale dhe tjetrit jo. Të dhënat e akumuluar treguan një reduktim të infeksionit me HIV në masën 27% tek gratë që kishin vendosur unazën vaginale me dapivirinë. Studimi i dytë u krye tek 1959 gra në Afrikën e Jugut dhe Ugandë, ku u përsërit i njëjti studim dhe reduktimi i infeksionit nga përdorimi i unazës vaginale ishte 30.7%.

## Lotus Exige Sport 410 që kushton 117.000 euro

Lotus ka futur në gamën e tij Exige një version të ri. Bëhet fjalë për Exige Sport 410, që i bashkohet Exige Sport

350 dhe Cup 430. Ky mjet arrin nga 0 në 100 km/h për 3,4 sekonda dhe ka një shpejtësi maksimale prej 290 km/h. Çmi-

mi i kësaj makine fantastike është 117.000 euro, pa përfshirë këtu pjesët opsionale që klienti dëshiron t'i shtojë.



1386 - Traktati i Vindorit mes Portugalisë dhe Anglisë.

1502 - Kolombo nisët nga Spanja në lundrimin e tij të katërt dhe të fundit drejt Botës së Re.

1689 - Mbreti anglez Willem III i shpallë luftë Francës.

1766 - John Byron kthehet në Angli pas një udhëtimi të tij përreth botës.

1901 - Australia hap parlamentin e saj të parë në Melburn.

1955 - Republika Federale e Gjermanisë i bashkohet NATO-s.

1960 - Nigeria bëhet pjesë e Shteteve të Komonveltit.

1964 - Krushçovi viziton Egjiptin.

1988 - Ndërtesa e re e Parlamentit të Australisë në Kanbera hapet nga Mbretëresha Elizabeta.


2004 - Vritet kryetari i Çeçenisë Ahmet Kadirov nga një eksplozim në një fushë të minuar gjatë një parade përkujtimore të Luftës së Dytë Botërore në Grozni të Çeçenisë.

Yjet neutrone janë kaq të dendur, sa që një lugë çaji do të peshojë më shumë se të gjithë njerëzit mbi Tokë.



Gjirafat flenë shpesh vetëm 20 minuta në çdo 24 orë.

Ato mund të flenë maksimumi deri në 2 orë (me intervale dhe jo në një kohë), por kjo ndodh rrallë. Gjirafat nuk shtrihen kurrë përtokë.



Plagët e infektuara me krimba shërohen më shpejt dhe pa përhapjen e gangrenës apo infeksioneve të tjera.



### PACIENTIA DHE PSIKOLOGU

Pacientja : Doktor, jam 15 vjeçe dhe shtatzënë, si t'u them prindërve? Psikologu: Hap gojën e thuaji, përdërisa di të hapësh këmbët, di të hapësh dhe gojën...



Lloji më i keq i armiqve janë lajkatarët. (Jules Renard)